

Prof. Dr. Masar RIZVANOLLI

VEPRIMTARIA E AHMET EFENDI KORONICËS GJATË LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

- Me rastin e 125 vjetorit të vdekjes -

Kriza Lindore e viteve 1875-1878, në radhë të parë luftërat malazezo-osmane, serbo-osmane, ruso-osmane, disfatat e ushtrisë osmane në frontet e luftës, pushtimi i tokave të banuara me shqiptarë nga fqinjët veriorë- Serbia dhe Mali i Zi, numri i madh i muhaxhirëve shqiptarë që vërshuan në vilajetet e Shkodrës dhe të Kosovës dhe gjendja e tyre e mjerueshme, shkaktuan një tronditje të paparë të popullsisë shqiptare jo vetëm në viset kufitare, të kërcënuara drejtpërdrejt nga ushtritë pushtuese, por edhe te shqiptarët e viseve të brendshme, të cilët u bindën më shumë se asnjëherë më parë se Perandoria Osmane nuk do të ishte në gjendje të mbrojë shtetasit e saj nga kërcënimet e jashtme. Prandaj, në këto rrethana dramatike, Komiteti Shqiptar i Janinës, i kryesuar nga Abdyl Frashëri, vendosi që të shndërrohej nga një komitet ndërkrahinor në një komitet kombëtar shqiptar, i cili do të mbronte interesat e shqiptarëve në të gjitha vilajetet e banuara me shqiptarë. Kështu, udhëheqësit e Komitetit të Janinës ftuan në Stamboll, pos deputetëve të zgjedhur në parlamentin osman, edhe disa patriotë të tjerë të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që të merrnin pjesë në mbledhjen për formimin e një komiteti shqiptar, e cila u mbajt më 18 dhjetor 1877, me ç'rast u formua organizata patriotike Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare, apo siç quhet zakonisht Komiteti i Stambollit.¹ Si anëtar i këtij komiteti, në ballë të të cilit qëndronte Abdyl Frashëri, krahës Pashko Vasës, Jani Vretos, Sami Frashërit, Ymer Prizrenit, Zija Prishtinës, Iljaz Dibrës, Mehmet Ali Vrionit, Mihal Haritos, Seid

¹ Kristo Frashëri, Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) I. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë 1989. pp. 133 etc. Më tutje: K. Frashëri LSHP I. Idem, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881. Toena, Tiranë, 1997. 49. Më tutje: K. Frashëri, LSHP.

Toptanit, Mustafa Vlorës, Mane Tahirit e të tjerëve, përmendet edhe Ahmet efendi Koronica.²

Pas shumë debatesh rreth miratimit të programit politik, i cili në fillim mbronte idenë e organizimit të kryengritjes së armatosur kundër pushtimit osman dhe të formimit të shtetit kombëtar shqiptar si synim afatgjatë të shqiptarëve dhe programit taktik që nënkuptonte bashkëpunimin e mundshëm shqiptaro-grek,³ shumica e anëtarëve të Komitetit të Stambollit u kthyen në atdhe. Aty gjetën një atmosferë tronditëse politike, të shkaktuar nga përparimi i shpejtë i ushtrive ruse, serbe, malazeze dhe nga gjendja e mjerueshme e refugjatëve të dëbuar me forcën e armëve nga trojet e tyre shekullore.⁴

Në Gjakovë Ahmet efendi Koronica hasi në një gjendje tejet të tendosur. Në qytet dhe në rrethinën e tij kishte filluar të shtohet pakënaqësia ndaj pushtetit osman që në ditët e para të Krizës Lindore 1875-1878, atëherë kur Porta e Lartë po bënte përpjekje për t'i rekrutuar në masë shqiptarët në radhët e bashibozukëve, të cilët dëshironte t'i shfrytëzonte kundër Serbisë dhe Malit të Zi, që ishin në luftë kundër Perandorisë Osmane. Mirëpo, shqiptarët, si gjithmonë, edhe kësaj radhe e shikonin me simpati luftën e popujve fqinj për pavarësi kombëtare dhe ishin të gatshëm të ndërmirmin aksione të përbashkëta kundër Portës së Lartë.⁵ Më 1876 Gjakova me Malësinë e saj refuzojnë mobilizimin ushtarak që ndërmorën autoritetet qeveritare osmane,⁶ ndërsa fiset e Krasniqes dhe të Gashit u ngritën në luftë kundër ushtrisë osmane gjatë luftës malazezo-osmane.⁷ Konsulli austro-hungarez në Prizren, Lipiçi, i raportonte ministrit të tij të Punëve të Jashtme, Andrashit, pos tjerash, edhe këtë: "...fiset malore më të forta, ato të Gjakovës, duke përdorur pretekste të ndryshme, deri sot nuk janë pajtuar të nisen, këtu nuk duhet të harrojmë se ato ç'prej vitesh kanë një marrëveshje të fshehtë me Malin e Zi."⁸ Edhe ato reparte të parregullta që u grumbulluan

² Op. cit. 134.

³ Ibid.

⁴ Op. cit. 39.

⁵ Dr. Jovan Hadži-Vasiljević, Arbanaska Liga-Arnavtska Kongra i Srpski narod u Turskom Carstvu (1878-1882). Beograd, 1909. 19. I. G. Senkevič, Albanija v period vastočnava krizisa (1875-1881gg.). Akademija Nayk SSSR, Institut Istarii. Moskva, 1965. 72. K. Frashëri, LSHP I. 114.

⁶ Arhiv Vojnoistorijskog Instituta u Beogradu, Knjiga izveštaja sa granice o neprijatelju. 4.V.1876-8.VI.1876. Popisnik 2, kutija 3.

⁷ Sadullah Brestovci, Lëvizja kombëtare shqiptare dhe marrëdhëniet shqiptaro-serbe-malazeze gjatë Krizës lindore 1875-1878. Enti i Historisë së Kosovës. Kosova 3. Prishtinë 1974. 89.

⁸ Lipiçi, Andrashit, Prizren 5 korrik 1878. Arkivi i Institutit Historik të Tiranës. Më tutje: AIHT

me shumë vështirësi në Gjakovë nga autoritetet qeveritare osmane, pasi u nisën në luftë kundër Malit të Zi, më 18 gusht, filluan të dezertinin masivisht. Nga 3 mijë vetë sa u nisën në fillin kishin mbetur vetëm 600-800.⁹

Luftërat serbo-osmane dhe malazezo-osmane kishin shkaktuar një gjendje anarkie, të cilën e shfrytëzuan grupe të ndryshme plaçkitësish¹⁰ dhe një kaos ekonomik që pasqyrohej, pos tjerash, edhe në zhvlerësimin e monedhës.¹¹

Mirëpo, ushtritë serbe dhe malazeze, të cilat dëbuan forcat osmane nga viset ku banonin edhe popullsi shqiptare, filluan spastrimet etnike të popullsisë vendëse shqiptare, e cila përjetoi vrasje, dhunime dhe mizori të papara që shkaktuan shqetësim të madh në krahinat kufitare. Madje, këto shkaktuan pakënaqësi edhe te disa qarqe ushtarake dhe intelektuale të këtyre vendeve, si dhe të përfaqësuesve diplomatikë të Fuqive të Mëdha.¹² Këto sjellje jonjerëzore shkaktuan vlime të mëdha në Gjakovë, në Prizren dhe në vise të tjera.¹³ Vetëm në qytetin e Gjakovës gjendeshin 2400 muhaxhirë të paushqyer, të paveshur, të përfshirë nga epidemia e tifusit.¹⁴

⁹ Raport i konsullit austro-hungarez, Jelinekut dërguar ministrit të Punëve të Jashtme-kontit Andrashi, Prizren 18 shtator 1877. Leka VI-XII, Vëll. II, Shkodër, 1940. 134.

¹⁰ Cf. Raportet e Lipiçit Andrashit, Prizren 7 e 14 korrik 1878. AIHT.

Duke përshkruar gjendjen kaotike në Prizren, si rrjedhojë e luftës, Lipiçi, pos tjerash, raporton: "Unë nuk guxoj ta lodh shkëlqesinë tuaj me skenat e lemerisë që ndodhën këtë ditë, as nuk mund të numroj masat që u morën shpejt e shpejt, por mjaftohem të ju raportoj se kadiu Ahmet efendiu (Koronica?-MR), i cili ç'prej njesjes së Fehim pashës (mytesarritit të Prizrenit-MR) kryen veprimet e tij ad interim, nuk mungoi të tregonte energji dhe kujdes." Prizren, 14 korrik 1878. AIHT.

¹¹ "Prizreni është inondue me banknotë. Si rrjedhojë, me përjashtim të disa spekulantëve, e gjithë klasa e tregtarëve dhe artizanëve humbet për çdo ditë. Secili mundohet ta heqë qafe përsëri sa më shpejt kartmonedhën që i është imponuar. Ndër të gjitha pjacat tregtare të këtushme Gjakova është e vetmja që refuzoi pranimin e kartmonedhës dhe refuzimin e saj e motivoi me at se do të ishte më mirë ta linte rehat Shqipërinë me të tilla kërkesa," i raporton Lipiçi Andrashit, Prizren 30 dhjetor 1878. AIHT.

¹² J. Hadži-Vasiljević, Arb. Liga. 11-20. Dr. Sabit Uka, Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit 1877-1878. Prishtinë, 1994. 56. Propozim dërguar ministrit të Punëve të Jashtme të Sërbisë mbi masat për "kthyerjen e shqiptarëve të ikur...në vatrat e tyre të mëparshme." Beograd 3 shtator 1880. Arkivi i Kosovës.

¹³ Raporti i konsullit grek, Mavromatit-ministrit të Punëve të Jashtme, Delyannit. Shkodër 18 shkurt 1878. Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente angleze (1878-1881). Dokumentet i transkriboi, i shqipëroi dhe i komentoi Prof. Dr. Skënder Rizaj. Arkivi i Kosovës, Prishtinë 1978. 48. Më tutje: LSHP në dok angleze.

¹⁴ Cf. Bogumil Hrabak, Prvi izveštaji konzula velikih sila o Prizrenskoj Ligi. Balcanica IX. Srpska Akademija Nauka i Umetnosti, Beograd, 1978. 237-238.

Gjendja e krijuar nga rreziku i pushtimit të tokave shqiptare prej shteteve fqinje shkaktoi shpërthimin e një dufi patriotik, që përfshiu të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare, madje edhe në ato vise të cilat nuk kërcënoheshin drejtpërdrejt nga rreziku i jashtëm. Kjo zgjoi edhe interesimin e Fuqive të Mëdha, të cilat filluan, nëpërmjet të përfaqësuesve të tyre, të krijonin kontaktet e para me krerët e lëvizjes çlirimtare shqiptare. Kështu, sipas një burimi serb, përfaqësuesit e Anglisë, që nga viti 1877, mbanin kontakte të shpeshta me Haxhi Zekën dhe Ahmet Koronicën dhe bënë propagandë në Kosovë në favor të Anglisë.¹⁵ Edhe konsulli austro-hungarez në Prizren, Jelineku, dragomani i tij shqiptar nga Prizreni, Balto Tarabulluzi, dhe disa priftërinj katolikë që kishin mendime të njëjta me ta agjitonin në Prizren, në Gjakovë, në Pejë dhe në vende të tjera kundër Serbisë dhe Malit të Zi me qëllim që t'i bindnin krerët e lëvizjes çlirimtare dhe popullsinë e këtyre vendeve për të kërkuar bashkimin me Austro-Hungarinë, e cila iu premtonte autonominë në kuadër të Monarkisë Dualiste.¹⁶

Sulltani, nga ana tjetër, gjithashtu, dëshironte t'i mbante në anën e tij shqiptarët e zhgënjyer në Perandorinë Osmane, e cila u tregua e paaftë për t'i mbrojtur tokat e të parëve të tyre. Për këtë arsye iu shkroi krerëve fetarë Ahmet efendi Koronicës, kadiut të Gjakovës, Ymer efendiut, myderrizit të Prizrenit dhe Jonuz Zyhdi efendiut, myftiut të Dibrës letrë,¹⁷ përmbajtja e saktë e të cilave nuk është e njohur.

Nënshkrimi i Traktatit të Shën Stefanit e ashpërsoi edhe më shumë gjendjen edhe më parë të tendosur në Shqipëri, të cilën e përfshiu vala e protestave kundër copëtimit të tokave shqiptare nga shtetet fqinje. Në shumë qytete shqiptare u formuan komisione vendore, të cilat organizonin forca ushtarake për mbrojtjen e tokave të tyre, për mbledhjen e ndihmave materiale për muhaxhirët që bridhnin rrugëve dhe për armatimin dhe ushqimin e forcave të armatosura vullnetare të vetëmbrojtjes.¹⁸ Kjo atmosferë kishte përfshirë, qysh në prill 1878, edhe Gjakovën me rrethinë.¹⁹ Sipas një burimi serb nga Peja, shqiptarët kishin vendosur të mblidheshin të gjithë "i madh e i vogël dhe të sulmonin Serbinë...dhe krerët (e Pejës)

¹⁵ Raport i të besuarit serb, Steiqit nga Prizreni 15.X.1877-26.VI.1878. Diplomatski Arhiv Sekretarijata za Inostrane Poslove, PO 1878, F-4. nr. 478. Më tutje: DA SIP. Kah fundi i prillit 1878 erdhën në Shqipëri disa agjentë të fshehtë dhe iu treguan shqiptarëve se Anglia ishte e vendosur të luftojë për mbrojtjen e Perandorisë Osmane. (K. Frashëri, LSHP I. 165.).

¹⁶ Ibid.

¹⁷ Xhafer Belegu, Lidhja e Prizrenit e veprimet e saja 1878-1881. Tiranë, 1939. 17.

¹⁸ B. Hrabak, Prvi izveštaji. 237-238. Cf. K. Frashëri, LSHP I. 162.

¹⁹ Raport i Lipiç-it, konsullit austro-hungarez, Andrashit, Shkodër 11 maj 1878 dhe Raport i Jelinekut, Andrashit, Prizren 14 maj 1878. AIHT. Leka 544. B. Hrabak, Prvi izveštaji. 237. K. Frashëri, LSHP I. 162. Cf. Raport i Steiqit. DA SIP etc.

shkuan në Rekë dhe në Gjakovë për ta lidhur besën për t'u nisur pas disa ditësh.”²⁰ Në fund të prillit, në këshillimet që u mbajtën në Gjakovë, ku morën pjesë përfaqësues nga Luma, Dibra dhe Tetova, u vendos që, për shkak të rrethanave të krijuara politike, të ndërpritet hakmarja dhe armiqësitë e tjera, që të mos dërgohen rekrutët që i kërkonte Porta, që të mos paguheshin tatimet dhe taksat e tjera, që çdo fis t'i përgatisë rezervat e armëve, të municionit dhe të ushqimit.²¹ Në këtë kuvend, gjithashtu, u shqyrtua mundësia e mbajtjes së një kuvendi, në të cilin do të merrnin pjesë përfaqësuesit e të gjitha fiseve shqiptare. Kuvendi i përmendur, që do të mbahej në Prizren ose në Lumë në fillim të majit 1878, do të miratonte vendimet përfundimtare mbi gjendjen e mjerë në të cilën ishte katandisur vendi. Në rast se sulltani nuk do t'i përfillte kërkesat e kuvendit të ardhshëm, atëherë lëvizja e deriatëhershme kundër qeverisë së Stambollit do të shndërrohej në kryengritje të haptë të armatosur.²²

Krerët e lëvizjes popullore në Gjakovë, pos përgatitjeve konkrete që bënin për mbrojtjen e terësisë tokësore të Shqipërisë, iu drejtuan me protesta edhe Fuqive të Mëdha kundër vendimeve të padrejta të Marrëveshjes së Shën Stefanit, që shkelnin të drejtat më elementare njerëzore të popullit shqiptar.²³

Sipas një burimi serb, më 10 maj 1878 u mbajt në Gjakovë një mbledhje ku morën pjesë krerët e Gjakovës, të Pejës dhe të Prizrenit. Me propozimin e Haxhi Zekës aty u vendos të çoheshin në kryengritje kundër Portës së Lartë të gjithë luftëtarët e aftë për armë prej moshës 7 deri në 70 vjeç.²⁴

Lëvizja për thirrjen e një kuvendi mbarëkombëtar, i cili do të vendoste mbrojtjen me armë të të gjitha tokave shqiptare kishte përfshirë të gjitha viset shqiptare dhe të gjitha shtresat shoqërore. Prandaj, Komiteti i Stambollit, i cili mori nismën për formimin e Lidhjes Shqiptare, nuk e kishte aq vështirë për t'ia arritur këtij qëllimi. Ai zgjodhi një komision të posaçëm për organizimin praktik të një kuvendi kombëtar. Sot dimë shumë pak për numrin dhe emrat e anëtarëve të tij. Dihet vetëm se shumica ishin nga Prizreni dhe Gjakova. Prej tyre njohim vetëm emrat e Ymer efendi Prizrenit

²⁰ Komuna ortodokse e Pejës, mitropolitit Milentije në Prishtinë, Pejë 5(18) prill 1878. Protokol pisama Opštine pečke 1870-1880. Priredili Jovan Pejin i Milić Petrović. Priština, 1992. 82.

²¹ B. Hrabak, Prvi izveštaji. 237. K. Frashëri, LSHP I. 162.

²² Ibid. Cf. Jelineku, Andrashit, Prizren 14 maj 1878; Lippih, Andrashit, Shkodër, 18 maj 1878. AIHT.

²³ Shiko raportet e shumta të diplomatëve të huaj nga Prizreni dhe Shkodra në Leka, në Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptre, në Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit etj.

²⁴ Raport i Steiqit, Prizren 15.XI.1877-26.VI.1878. DA SIP.

dhe të Ahmet efendi Koronicës. Komisioni kishte për detyrë të fronte zyrtarisht të gjitha krahinat e vendit për të dërguar delegatët në kuvendin kombëtar të Prizrenit dhe të caktonte datën e mbajtjes së tij.²⁵

Sipas disa autorëve, nga fundi i majit 1878 u mbajt në Gjakovë një mbledhje e përfaqësuesve të Shqipërisë Veriore, në të cilën u vendos që të ftoheshin përfaqësuesit e të gjitha viseve shqiptare në një kuvend të përgjithshëm, i cili do të mbahej më 10 qershor 1878, në prag të mbajtjes së Kongresit të Berlinit.²⁶

Ahmet efendi Koronica bashkë me Abdyl Frashërin, Iljaz pashë Dibrën, Sheh Mustafa Tetovën, Ali bej Gucinë etj. të ftuar në Stamboll te sulltani, kur panë se ai po e zvarriste me qëllim audiencën, u nisën për në Kosovë në mëngjesin e 8 qershorit. Në Selanik u bashkuan me ta edhe delegatët e tjerë të Vilajetit të Janinës. Në Prizren aritën në mbrëmje, më 9 qershor 1878.²⁷

Sipas një raporti dërguar qeverisë serbe nga Prizreni, kontribut të madh në organizimin e kuvendit themelues të Lidhjes Shqiptare dha Ahmet Koronica, i cili kishte ardhur në Prizren nga Selaniku për t'i tubuar njerëzit nga tërë Shqipëria Veriore dhe për t'i bashkuar në luftë kundër Serbisë dhe Malit të Zi. Ai, gjithnjë sipas këtij raporti, i kishte ftuar telegrafisht në një kuvend të përbashkër krerët e të gjitha qyteteve të Rumelisë, të Shqipërisë, të Bosnjës dhe të Hercegovinës.²⁸ Konsulli austro-hungarez i Shkodrës Lipiçi e radhiste Ahmet efendi Koronicën, gjykatësin e Gjakovës, si njërin nga figurat më të shquara që mermin pjesë në Kuvendin e Përgjithshëm në Prizren krahas Ali beg Gucisë, Iljaz pashë Dibrës, Hasan pashë Tetovës dhe Abdullah pashë Drenit.²⁹

Të përmendim se në luftën për caktimin e programit të Lidhjes, që filloi menjëherë pas themelimit të saj, u shprehën në mënyrë të vrazhdë dallimet që ekzistonin edhe më parë midis atyre tri rrymave, të njohura në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare: rrymës patriotke, rrymës sulltaniste dhe rrymës së moderuar. Interesi i përbashkët i tyre që i bashkoi në Lidhjen Shqiptare ishte ruajtja e kufijve të Perandorisë Osmane, që ishin cënuar nga Traktati i Shën

²⁵ K. Frashëri, LSHP I. 170. Cf. J. Hadži-Vasiljević, Arb. Liga. 37-41.

²⁶ Xh. Belegu, Lidh. e Prizrenit. 17. I. G. Senkević, Albanija v period. vast. krizz. 102.

²⁷ K. Frashëri, LSHP I. 175.

²⁸ Raport i Steiqit, Prizren 15.XI.1877-26.VI.1878. DA SIP. Shukri Rrahimi, Elemente të shtetësisë në Lidhjen e Prizrenit. Jehona 2, Shkup, 1878. 162. Idem, Vilajeti i Kosovës 1878-1912. Prishtinë 1969. 55.

²⁹ Lippih, Shkodër, 22 qershor 1878. AIHT. K. Frashëri, LSHP I. 179.

Sipas Lipiçit gati të gjithë të përmendurit "ishin kajmekamë rajoni ose janë ende" me përjashtim të A. Koronicës.

Sipas J. Haxhi-Vasileviqit, në Këshillin kryesor të Lidhjes, nga Gjakova me rrethinë bënin pjesë S. Vokshi, A. Dreni, A. Koronica, Sh. Curri, B. Alija etj. J. Hadži-Vasiljević, Arb. Liga. 41. Raporti i Steiqit, DA SIP.

Stefanit. Sulltani me përkrahësit e tij e dëshironte formimin e një lidhjeje islamike, të kontrolluar nga Stambolli, në të cilën do të bashkoheshin myslimanët e Ballkanit në luftë për ruajtjen e terësisë territoriale të Perandorisë Osmane. Rryma e të moderuarve, e cila e pranonte formimin e një lidhjeje të përgjithshme me karakter kombëtar, e pranonte në parim idenë e formimit të një vilajeti të përbashkët shqiptar mbi bazën e një autonomie administrative dhe kulturore, i cili duhej të krijohet me pëlqimin e sulltanit. Ata mendonin se krijimi i vilajetit shqiptar nuk binte ndesh me interesat e Perandorisë Osmane, po të mirrejt parasysh rreziku që i kërcënohej vetë copëtimit të saj.

Rryma patriotike, e cila kishte përqaftuar platformën politike të Komitetit të Stambollit për formimin e shtetit autonom shqiptar si fazë e parë për formimin e shtetit të pavarur, gjeti pika të përbashkëta me të moderuarit, të cilët, gjithashtu, nuk pajtoheshin me platformën politike të qarqeve sulltaniste. Kjo u shpreh në protestat e shumta dërguar Portës së Lartë dhe Fuqive të Mëdha kundër Traktatit të Shën Stefanit. Prandaj, Porta e Lartë nga frika se lëvizja kundër Traktatit të Shën Stefanit mund t'i dilte doresh, ftoi, nga fundi i majit 1878, në Stamboll përsonalitetet më të shquara të jetës politike shqiptare, midis të cilëve edhe Ahmet efendi Koronicën, për të penguar formimin e një lidhjeje, e cila nuk do të ishte nën kontrollin e saj. Por, siç pamë, ata u nisën për Kosovë pa lejen e sulltanit dhe formuan Lidhjen e Prizrenit.

Lufta e ashpër politike u zhvillua brenda Kuvendit të Përgjithshëm me rastin e miratimit të dokumenteve të para të Lidhjes. Karamamenë, të propozuar nga sulltanistët e nënshkruan vetëm 49 vetë nga rreth 110 sa ndodheshin në Kuvend. Nga 11 delegatë të Gjakovës atë e nënshkruan vetëm 4 sish. Ahmet efendi Koronica bashkë me Sylejman Vokshin, Bajram agë Gashin, Shaqir agë Currin, Binak Alinë, Ali Ibrën dhe Metali beun nuk e nënshkruan këtë dokument, që kishte për qëllim t'i jepte Lidhjes karakter islamik. Atë e nënshkruan vetëm Abdullah pashë Dreni, Mehmet Shaqir beu, Ahmet Hamdiu dhe Mehmet Kahremani.³⁰

Në Këshillin e Përgjithshëm të Lidhjes Shqiptare bënë pjesë përfaqësues të të gjitha rrymave politike, madje edhe sulltanistët, të cilët qëndruan edhe për një kohë në radhët e saj, ndonëse kishin pësuar disfatë politike. Këtu do të përmendim vetëm emrat e përfaqësuesve të rrymës radikale, midis të cilëve figuronte edhe Ahmet efendi Koronica, siç ishin Abdyl Frashëri, Ymer Prizreni, Sylejman Vokshi, Haxhi Zeka, Haxhi Shabani, Binak Alija, Ali Ibra etj.³¹

³⁰ K. Frashëri, LSHP I. 191.

³¹ Op. cit. 203.

Këshilli i Përgjithshëm i Lidhjes, pasi zgjodhi organet ekzekutive, miratoi një vendim sipas të cilit të gjithë anëtarët e tij duhej të shpërmdaheshin nëpër krahinat e tyre për të organizuar degët e Lidhjes Shqiptare dhe për të realizuar në çdo krahinë detyrat konkrete politike, organizative dhe ushtarake që dilnin nga dokumentet e miratuara në Kuvendin e Përgjithshëm gjatë punimeve trijavore të tij. Në Prizren qëndruan vetëm 7 anëtarë të Komitetit Kombëtar që kishin për detyrë të ndiqnin dhe të koordinonin punët e ditës.³²

Bashkë me delegatë të tjerë në Gjakovë u kthye edhe Ahmet efendi Koronica. Aty themeluan Degën e Lidhjes Shqiptare, e cila përfshinte trevat e Gashit, të Krasniqes, të Hasit, të Bytyçit, të Rekes, të Dushkajës etj. Ndonëse kryetar i parë i Degës në Gjakovë ishte Abdullah pashë Dreni, që i takonte krahut sulltanist të Lidhjes Shqiptare, Ahmet efendi Koronica bashkë me Sylejman Vokshin dhe me bashkëpunëtorët e tjerë të krahut patriotik luanin një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e drejtë politike të Degës së Lidhjes Shqiptare në Gjakovë që u pa shumë shpejt pas ardhjes së Mehmet Ali pashës në Shqipëri. Madje, sipas disa burimeve, kadiu i Gjakovës duhet ta kishte pasur fjalën kryesore në Degën e Gjakovës, kur dihet se Sylejman Vokshi ishte i zënë me punë të shumta në Këshillin Kryesor të Lidhjes Shqiptare. Në një raport të togerit Roos të Blandesburgut, dërguar majorit Uilson nga Selaniku, oficeri anglez flet për karakterin, programin dhe udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare. Si udhëheqës në Prizren përmend Haxhi Ymer efendiun dhe Ymer efendiun, në Prishtinë myftiun e Prishtinës dhe Zija beun “një shqiptar të pasur, pronar tokash në Prishtinë dhe përreth saj,” ndërsa për Ahmet efendi Koronicën shkruan se “është udhëheqës në Gjakovë.” Më tutje vazhdon: “Në Pejë e Gjakovë janë të tjerët emrat e të cilëve nuk i di. Por këta, të cilët i përmenda janë personat më me ndikim.”³³

*
* *

Shpresat e shqiptarëve se Kongresi i Berlinit do t'i korrigjonte padrejtësitë e Traktatit të Shën Stefanit që kishi në të bënë me cenimin e tokave të tyre u treguan të kota. Edhe Kongresi i Berlinit i ndau nga trangu etnik disa vise shqiptare, të cilat duhej të kalonin nën sundimin e shteteve fqinje. Prandaj, si në viset e tjera shqiptare edhe në Gjakovë Dega e Lidhjes i

³² Op. cit. 204, 225.

³³ Skënder Rizaj, Nëntë dokumente angleze mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878-1880). Gjurmime albanologjike X-1980. Prishtinë 1981. 187.

filloi, që në korrik 1878, përgatitjet për mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë, me të cilat Gjakova kishte lidhje të ngushta.³⁴ Në fillim të gushtit ajo arriti të mobilizojë një numër të madh vullnetarësh.³⁵ Krerët e Lidhjes në Gjakovë ishin të brengosur për shkak të rrezikut që iu kërcënohej territoreve shqiptare nga depërtimi i Austro-Hungarisë në Pazarin e Ri dhe nga rreziku i rojave kufitare serbe. Jelineku e lajmëronte Andrashin se “Shefi i bashibozukëve Abdullah pashë Gjakova shkoi në Novi Pazar, ose më mirë të thuhet në Mitrovicë.”³⁶ Ai raporton edhe për një sulm kundër postave kufitare serbe, të cilat nuk iu përgjigjen zjarrit dhe u tërhoqën. Konsulli austro-hungarez i Prizrenit, gjithashtu, e njofton eprorin e tij në Vjenë “se disa reparte bashibozukësh të Gjakovës dhe fisi i Hasit, të nxitura nga kadiu i Gjakovës, Ahmet efendi Koronica, një revolucionar me nam, do të nisen në ditët e afërta,” por nuk ishte i sigurt “nëse marshi do të drejtohej kah Bosnja ose kundër serbëve.”³⁷ Me gjithë pakënaqësinë e shqiptarëve me vendimet e Kongresit të Berlinit, Porta e Lartë, nën tryshninë e Malit të Zi dhe të Fuqive të Mëdha, emëroi Mehmet Ali pashën komisar për vendsjen e kufijve të rinj me Serbinë dhe me Malin e Zi. Prandaj, në fillim të gushtit 1878 u ftuan urgjentisht në Prizren disa anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm nga Dibra, Gjakova, Peja dhe nga qendra të tjera për të shqyrtuar masat që duhej marrë përballë kërcënimeve malazeze dhe gatishmërisë së Portës së Lartë për të dorëzuar Plavën dhe Gucinë.³⁸ Nga Gjakova arritën në Prizren, sipas disa lajmeve që sjell një burim austro-hungarez nga Prizreni, anëtarët e Këshillit Bajram aga, prijës i bashibozukëve, anëtari i mexhlisit, Sylejman Vokshi dhe kadiu Ahmet Koronica.³⁹ Më 14 gusht në Prizren u mbajt një mbledhje në të cilën u shqyrtua çështja e Plavës dhe Gucisë. Përfaqësuesit e rrymës sulltaniste në Lidhje kërkonin me këmbëngulje të respektohej vullneti i Portës së Lartë, ndërsa përfaqësuesit e rrymës patriotike, përkundrazi, kërkonin mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë dhe të çdo pëllëmbë të tokave shqiptare me forcën e armëve, të cilat do t’i drejtonin kundër kujtdo që do t’i cenonte interesat e popullit shqiptar.⁴⁰

Mehmet Ali pasha, pasi i njoftoi, nëpërmjet kanalesh diplomatike, përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha, të Serbisë dhe të Malit të Zi me misionin e

³⁴ Historia e Popullit Shqiptar II. Prishtinë, 1969. 132.

³⁵ Cf. “Narodni glasnik,” Beograd 23 korrik (4 gusht) 1878.

Që në korik 1878 “prej Prizreni dhe Gjakove u nisën të deleguar për Mitrovicë për të marrë armë e minicion.” Jelineku, Andrashit, Prizren, 8 e 30 korrik 1878. AIHT.

³⁶ Jelineku, Andrashit, Prizren, 6 gusht dhe 15 shtator 1878. AIHT.

³⁷ Ibid.

³⁸ Xh. Belegu, Lidhja e Prizrenit. 44.

³⁹ B. Hrabak, Prvi izveštaji. 265.

⁴⁰ Cf. Xh. Belegu, Lidh. e Priz. 44. B. Hrabak, Prvi izveštaji. 264.

tij, arriti në Prizren më 25 gusht 1878. Menjëherë ai ftoi në bisedë disa krerë të Lidhjes, miq të tij të vjetër, të cilët u orvat t'i bindë për ta çuar në vend kërkesën e sulltanit për dorëzimin e Plavës dhe të Gucisë. Nga ana tjetër, ai dërgoi në Guci një komision të posaçëm për të shqyrtuar mundësitë për dorëzimin paqësor të këtyre territoreve Malit të Zi.⁴¹ Të nesërmen, më 26 gusht, mareshali osman ftoi në mbledhje Këshillin Kryesor të Lidhjes dhe parinë e vendit dhe kërkoi nga të pranishmit që t'i praninin kërkesat e Portës së Lartë dhe të Fuqive të Mëdha, duke theksuar se çdo veprim i kundërt do të ishte në dëm të vetë shqiptarëve dhe të Perandorisë Osmane.⁴² Si duket gati të gjithë krerët e Lidhjes, me përjashtim të disa sulltanistëve, i kundërshtuan kërkesat e përfaqësuesit të sulltanit.⁴³ Midis tyre u dallua Ahmet efendi Koronica. Në një raport të Jelinekut dërguar Andrashit, ndër të tjera, lexojmë: "Kadiu Ahmet efendi Koronica i Gjakovës protestoi kundër pranimit përderisa traktati (i Berlinit-MR) i referohet shkëputjes së Gucisë, Plavës..."⁴⁴ Në një raport tjetër, të plotësuar me të dhëna të reja mbi misionin e mareshalit osman, po nga Prizreni thuhet se kundërshtarët më të rreptë të dorëzimit të Plavës dhe të Gucisë ishin Ali pashë Gucia, "pastaj kadiu fanatik Ahmet efendi Koronica, i njohur prej Shkëlqesisë Suaj (Andrashit-MR) që prej relacioneve të zotit konsull (të Shkodrës-MR) Lippih në vitin 1876...siç duket me porosi nga lart doli me rrëmbim të egër kundër shkëputjes së Plavës dhe Gucisë. Kur Mehmet Aliu i vuri në dukje Koronicës sjelljen e tij të pahijshme duke i dhënë të kuptojë se do të kishte të drejtën dhe forcën ta lidhë dhe ta dorëzojë në Stamboll, Koronica ia priti se

⁴¹ K. Frashëri, LSHP I. 248. Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane (1878-1881). Dokumentet i shqipëroi dhe i komentoi Ilijaz Rexha. Arkivi i Kosovës, Prishtinë 1978. 35. Më tutje: LP në dok. osmane. Dr. Skënder Rizaj, Vrasja e Mehmet Ali pashë Maxharrit në Gjakovë sipas gazetës "Terxhymani Shark" (1878). Horizontet e Historisë 2, Prishtinë 1978. 110.

⁴² B. Hrabak, Prvi izveštaji. 267. K. Frashëri, LSHP I. 248. Leka, 551, 561, 567.

⁴³ Ndonëse knjaz Nikola në memoaret e tij i shtrembëron këto ngjarje, të cilat i paraqet në mënyrë të cunguar, duke parashtruar në mënyrë tendencioze shkaqet e vërteta të tyre, ne do të shënojmë vetëm një fragment ku shihet se në fillim edhe disa sulltanistë ishin kundër dorëzimit të Plavës dhe të Gucisë. Ndër të tjera shkruan: "Mehmet Ali pasha porsa erdhi në Prizren i ftoi krerët shqiptarë si: Abdullah pashën nga Gjakova, Sheqer agën dhe Bajram agën nga Krasniqja etj. – dhe ua komunikoi dëshirën e sulltanit që Gucia t'i dorëzohet knjazit të Malit të Zi pa kundërshtim. Krerët u përgjigjen...se më parë do të vriteshin se sa do t'ia lëshonin Gucinë knjazit. Mehmet Ali pasha nuk i dha fort rëndësi lavdërimit dhe trimëritit shqiptar, por edhe krerët mendonin se Mehmet Ali pasha nuk mendonte seriozisht në dorëzim, por ato fjalë i tha vetëm sa për t'u dëgjuar." Nikola I Petrović Njegoš, Memoari. Cetinje-Titograd, 1988. 539-540.

⁴⁴ Jelineku, Andrashit, Prizren 7 shtator 1878. AIHT. Leka nr. 10-12, Shkodër 1938. 551.

ai (Mehmet Aliu) nuk mund ta bënte këtë se edhe ai (Koronica) ka porositë e tija prej Stambolli.”⁴⁵ Nga kjo shihet se Ahmet Koronica ishte një personalitet i rëndësishëm politik, i njohur mirë në qarqet politike të Stambollit, por, siç pamë më parë, edhe në ato të Vjenës.

Më 27 gusht 1878 dështoi mbledhja e ftuar nga Mehmet Ali pasha, ngase atë mbledhje e bojkotuan anëtarët e Këshillit Kryesor të Lidhjes. Madje, po atë ditë, në një kafene në Marash, Ramadan Zaskoci, i ngarkuar nga Lidhja, vrau telegrafishtin e mareshalit, i cili e mbante korrespondencën me Stambollin në gjuhën frënge, gjë që kishte shkaktuar dyshime në radhët e Lidhjes.⁴⁶ Posa mori këtë lajm që e tronditi pa masë, mareshali urdhëroi arrestimin e menjëhershëm të vrasësit. Por Ramadan Zaskoci, sipas një raporti të Jelinekut, me ndihmën e dy shokëve të tij dhe të masës së tubuar me at rast, kishte dalë nga qyteti dhe ishte strehuar në Gjakovë, ku e ndjente veten më të sigurt. Aty ishte në shërbim të Ahmet efendi Koronicës, të cilin e shoqëronte në çdo hap, si roje personale, me dy shokë të tjerë, të cilët e ndihmuan në atentat.⁴⁷ Konsulli austro-hungarez vazhdon më tutje se “personat e arrestuar këtu pas vrasjes së telegrafistit Argirias janë të gjithë prej Gjakove dhe me Koronicën duhet të jenë bashkëfajtorë për të gjitha krimet e kryera.”⁴⁸

Megjithë rrezikun që i kërcënohej jetës së tij, Mehmet Ali pasha shkoi, në mbrëmjen e 27 gushtit, i shoqëruar nga garda e tij personale, në selinë e Komitetit Kombëtar të Lidhjes për të kërkuar me këmbëngulje nga krerët e saj pranimin e dispozitave të Traktatit të Berlinit. Por, si edhe më parë, hasi në një kundërshtim të ashpër nga të pranishmit, disa nga të cilët, pas ofendimeve të rënda, deshën edhe ta sulmojnë fizikisht.⁴⁹ Siç duket në këto debate të ashpra u dallua Ahmet efendi Koronica.

Përfaqësuesit diplomatikë austro-hungarezë nga Prizreni dhe Shkodra i shtrembërojnë tërësisht këto fakte. Ata raportojnë gjoja se shumica e krerëve të Lidhjes i pranuan kërkesat e mareshalit osman, por Koronica kundërshtoi. Konsulli i Shkodrës, Lipiçi, ndër të tjera, shkruan: “Ahmet efendi u qysh në seancën e Komitetit më 27 gusht, ndërsa udhëheqësit e tjerë deklaruan, se

⁴⁵ Raport i Jelinekut-Andrashit, Prizren, 21 tetor 1878. AIHT. Leka 560.

⁴⁶ Jelineku, Andrashit, Prizren 31 gusht 1878. AIHT. K. Frashëri, LSHP I. 250. J. Hadži-Vasiljević, Arb. Kongra. 52. Xh. Belegu, Lidh. e Priz. 48. B. Hrabak, Prvi izveštaji. 268. Paulin Perja, Kronikë për aksionin e Gjakovës (gusht-shtator 1878). Kumlari 6, Shkodër 1993. Süleyman Külçe, Osmanlı tarihinde Arnavutluk. Izmir, 1944. 257.

⁴⁷ Jelineku, Andrashit, Prizren, 21 tetor 1878. AIHT. Leka.562.

S. Kylçe pohon se R. Zaskoci, i veshur me rrobe grash, iku në Lumë. S. Külçe, Arnavutluk. 257.

⁴⁸ Ibid.

⁴⁹ Cf. J. Hadži-Vasiljević, Arb. Kongra. 53. K. Frashëri, LSHP I. 251.

paku sa për shej, se do t'u nënshtrohen vendimeve të kongresit (të Berlinit-MR), protestoi kundër atyre, prandaj është e pashpjegueshme se si e zgjodhi atë Mehmet Aliu në komisionin e Gucisë.⁵⁰ Po këtë e pohon edhe konsulli i Prizrenit Jelineku, i cili, pos tjerash, raporton: "Për aq sa më sigurojnë, vetëm Koronica s'ka pranuar vënien e vulës së tij në dokumentin e pranimit (të kërkesave të mareshalit osman-MR) dhe ka vajtur menjëherë në Gjakovë që të frymëzojë popullin për qëndrim armiqsor kundër Mehmet Ali pashës, të cilin në Gjakovë e kanë bërë titullatrathtar i Orhanies."⁵¹

Pas këtij këmbimi fjalësh të rrepta Komiteti i Lidhjes vendosi të bllokojë rrugën nëpër të cilën duhej të kalonte përfaqësuesi i sulltanit për në Guci.⁵² Megjithë qëndresën e ashpër të shqiptarëve Mehmet Ali pasha vendosi të nisej për në Gjakovë në rrugën e tij drejt kufirit të Malit të Zi,⁵³ ku do të takohej me senatorin Petroviq për t'u marrë vesh rreth mënyrës së dorëzimit të Plavës dhe të Gucisë dhe, pos kësaj, do të vazhonte deri në Podgoricë ku supozohej se do të takohej me knjaz Nikolën.⁵⁴

Disa krerë të Lidhjes dhe disa nëpunës shtetërorë osmanë u orvatën ta bindnin përfaqësuesin e Portës që të mos nisej për në Gjakovë pa u marrë vesh më parë me Malësinë e Gjakovës dhe pa ia treguar shkaqet e udhëtimit të tij, "duke i thënë se banorët e Gjakovës janë shumë të rrezikshëm dhe se në atë mënyrë do ta rrezikojë jetën e vet." Më në fund mareshali osman pranoi që të formohej një komision, i cili do të shkonte në Gjakovë për "qetësimin e shpirtrave" të popullsisë së revoltuar. Komisioni në të cilin bënë pjesë Abdullah pashë Dreni dhe Ahmet efendi Koronica nga Gjakova, Murteza efendi dhe Osman efendi nga Prizreni, Iljaz pasha dhe Sadik beu nga Dibra, Hasan pashë Tetova, Dervish bej Luma dhe disa personalitete të tjera u nis, më 28 gusht 1878, për në Gjakovë për ta ndihmuar, gjoja, misionin e Mehmet Ali pashës. Mirëpo, me përjashtim të Abdullah pashë Drenit, anëtarët e tjerë kishin për qëllim pengimin e udhëtimit të pashait osman drejt Plavës dhe Gucisë.⁵⁵ Jelinek raporton se Ahmet Koronica "vetë

⁵⁰ Lippih-u, Andrashit, Shkodër, 14 shtator 1878. AIHT. Leka. 567.

⁵¹ Jelineku, Andrashit, Prizren, 21 tetor 1878. AIHT. Leka. 561.

⁵² K. Frashëri, LSHP I. 251.

⁵³ Xh. Belegu, Lidh. e Priz. 48. B. Hrabak, Prvi izveštaji. 268.

⁵⁴ Raport i Jelinekut, Andrashit, Prizren, 21 tetor 1878. AIHT. Leka. 560. Cf. Raport i Ponsit, drejtuesit të konsullatës së Francës në Shkodër - Vadingtonit, ministër i Punëve të Jashtme i Francës, Shkodër, 16 shtator 1878. Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I (1876-1879). Përgatitur nga Ligor Mile. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë 1978. 195. Më tutje: Shqip. në vitet e LSHP I.

⁵⁵ "Tercüman-i Şark," 11 shtator 1878. AIHT. S. Rizaj, Vrasja e Meh. Ali pashës. 110. LP në dok. osmane. 35. K. Frashëri, LSHP I.251. Jelineku, Andrashit, Prizren, 7 shtator 1878. AIHT. Leka. 551.

i ka pri Mehmet Ali Pashës për në Gjakovë, ku e ka ndjellë popullin me çue krye.”⁵⁶ Lipiçi gjithashtu e fajëson Ahmet Koronicën si nxitës të qëndresës kundër pashait osman. Ai raporton :”Tani del në paraskenë drejtuesi i vërtetë i kryengritjes së Gjakovës, kadiu Ahmet efendi Koronica, edhe ky një gjakovas me një famë më të keqe se çdo udhëheqës tjetër populli...është dinak, ka një energji të egër dhe është një patriot fanatik. Ky bashkë me Abdullah pashën dhe Hasan pashën, me kryetarët e bandave jo më pak famëkëqinj nga Tetova dhe Gjakova, shkuan atje përpara Mehmet Aliut që sa për dukje t’i qetësojnë banorët e Gucisë, por në realitet me urdhër të komitetit, për të përgatitur aktin e fundit të tragjedisë, duke mobilizuar fiset e malësisë dhe duke nxitur popullin e Gjakovës dhe të Pejës.”⁵⁷

Por, para se të merrte përgjigje nga komisioni për qetësimin e popullsisë së revoltuar, Mehmet Ali pasha u nis për në Gjakovë më 31 gusht 1878 për ta shpallur zyrtarisht hyrjen në fuqi të Traktatit të Berlinit, të ratifikuar nga Porta e Lartë, që më 3 gusht 1878, dhe për të vazhduar rrugën për në Guci.⁵⁸ Dega e Lidhjes Shqiptare në Gjakovë shpalli kushtimin me anën e të cilit ftoi të gjithë meshkujt e aftë për armë për ta penguar shkuarjen e këtij “murtati” në Guci. Në qytet dhe rreth tij u grumbulluan luftëtarë nga Gjakova, Reka, Gashi, Krasniqja, Bytyçi, Hasi dhe Peja.⁵⁹ Më 1 shtator 1878, në malin e Hereçit arriti edhe Ali pashë Gucia me forcat e tij që përbëheshin nga mijëra malësorë të armatosur me qëllim që ta kontrollojë rrugën që çonte për në Guci.⁶⁰ Dy mijë vullnetarë nga Gjakova, Reka e Malësia që gjendeshin në Plavë e Guci, sapo mësuan për ardhjen e Mehmet Ali pashës, u kthyen për shtatë orë në Gjakovë nëpër bjeshkën e Bogiçes. Atyre iu bashkuan edhe shumë plavjanë e gucianë.⁶¹ Sipas Haxhi-Vasileviqit në Malin e Hereçit ishin të fshehur 6 mijë luftëtarë. “Udhëheqës dhe epror kryesor i këtyre shqiptarëve në Malin e Hereçit, sipas tij, ishte Korenica i njohur, ndërsa i atyre në Plavë dhe Guci, Ali pasha i Gucisë.”⁶² Mareshali osman posa mori vesh për pusinë e shqiptarëve në Hereç iu bind këshillës së Abdullah pashë Drenit për të mos e lëshuar përkohësisht Gjakovën.⁶³ Nga

⁵⁶ Jelineku, Andrashit, Prizren, 10 shtator, 21 tetor 1878. Leka. 551, 561.

⁵⁷ Lippih, Andrashit, Shkodër, 14 shtator 1878. AIHT. Leka. 567.

⁵⁸ K. Frashëri, LSHP I.252. S. Rizaj, Vrasja e Meh. Ai pashës. 110. LP në dok. osmane. 35.

⁵⁹ Raport i Lippih-ut, Shkodër, 7 tetor 1878. Arkivi i Kosovës.

⁶⁰ J. Hadži-Vasiljević, Arb. Liga. 58. K.Frashëri, LSHP I. 252.

⁶¹ Mustafa Memić, Karakteristike pokreta otpora protiv sprovođenja odluka Berlinskog Kongresa u Gusinskom okrugu (1878-1880).Prilozi Instituta za Istoriju u Sarajevu, br. 16. god.XV, Sarajevo 1979. 65. Idem, Plav i Gusinje u prošlosti. Kultura, Beograd, 1989. 155.

⁶² J. Hadži-Vasiljević, Arb. Liga. 54.

⁶³ Ibid.

ana tjetër, kryengritësit e fshehur në Malin e Hereçit, kur morën vesh se mareshali osman nuk do ta vazhdojë rrugën drejt kufirit, i lëshuan pozicionet e tyre dhe bashkë me Ali pashë Gucinë ranë në Gjakovë.⁶⁴ Kjo sjellje ishte në frymën e marrëveshjes së arritur më heret me gjakovarët në praninë e tij dhe të Jakup Ferit.⁶⁵

Me të arritur në Gjakovë Mehmet Ali pasha ftoi parinë e qytetit në bisedime për t'i njoftuar me misionin e tij. Për këto ngjarje bëjnë fjalë, pos burimeve të tjera, edhe disa burime shqiptare, disa dëshmitarë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në to, që na krijojnë një paqyrë më besnike të atmosferës së rëndë që mbretëroi në bisedimet e ashpra midis pashait osman dhe përfaqësuesve të Degës së Lidhjes, në radhë të parë të Ahmet Koronicës.

Sipas një anonimi gjakovar, krerët e qytetit, të mbledhur në kuvend për të shqyrtuar gjendjen e krijuar, shpallën kushtrimin drejtuar banorëve të Rekës dhe Malësisë: "Hiçni i madh e j vogel se na ka ardh ni murat, Mehmet Ali Pashë Maxharri me na çart besen e me lshu Plavë e Guci e me na marr Shkau krejt."⁶⁶ Gjithnjë sipas të njëjtit burim, kuvendi i krerëve të qytetit u mbledh në Terzhane, në zyren e esnafit të terzive, ku u zgjodh komisioni për të biseduar me përfaqësuesin e sulltanit, i pëbërë nga kadiu Ahmet efendi Koronica, Sylejman agë Vokshi, Ismail efendi, myderrizi i Medresesë së Madhe dhe krerë të tjerë të Degës së Lidhjes në Gjakovë, të cilët me shumicë votash vendosën të kundërshtojnë dorëzimin e Plavës dhe të Gucisë.⁶⁷ Një pjesëmarrës tjetër i këtyre ngjarjeve, Ymer Shaba, pohon se këtë vendim e kundërshtoi Abdullah pashë Dreni, i cili "s'kandisi kurrqyshë m'e thye fermanin e Mretit." (sulltanit-MR).⁶⁸

Bisedimet e rrepta me mareshalin osman u zhilluan të dielën në mbremje, më 1 shtator 1878. Midis përfaqësuesve gjakovarë u dallua për gjuhën e ashpër, kadiu i Gjakovës, Ahmet efendi Koronica, i cili, sipas Ton

⁶⁴ K. Frashëri, LSHP I. 252.

⁶⁵ M. Memić, Karak. pok. otpora. 62. Anonimi gjakovar, Kujtime. Arkivi Qëndror Shtetëror në Tiranë, Fondi Lidhja e Prizrenit, dosja 7. faqe 2. K. Frashëri, LSHP I. 252.

⁶⁶ Anonimi gjakovar, Kujtime. Arkivi Qëndror Shtetëror në Tiranë. F.143. d .855. f. 1. K. Frashëri, LSHP I. 253. Xh. Belegu, Lidh. e Priz. 49.

⁶⁷ Ibid. Xh. Belegu, Lidh. e Priz. 50. Cf. Ton Gulia, Vrasja e Mehmet Ali pashë Maxharrit. "Fjamuri i Arbërit." Cozenca, 20 qershor 1883. AQSH. F. 143, d. 855, f. 6.

Sipas një kronike të kohës, më 1 shtator 1878, paria e Gjakovës u mbledhën te mejtepi Ruzhdie e nuk dihet se çka biseduan, por te Mehmet Ali pasha nuk shkuan. Cf. P. Perja, Kronikë për aksionin e Gjakovës. 247.

⁶⁸ Ymer Shaba, i lindur në Kuç, por i shpërmgullur në Guci, plak 113 vjeçar kur i dha këto shenime, pjesëmarrës në tradhët e ushtrisë së Ali pashë Gucisë. Cf. Murat Paci, Ali Pashë Gusija. "Hylli i Dritës," 6, Shkodër 1938. 311. K. Frashëri, LSHP I. 253.

Gulisë, pjesëmarrës në bisedime, ishte “një hoxhë i gishtit dhe i divitit, që kurdoherë mbante në një dorë pushkën dhe në tjetrën xhybenë.”⁶⁹ Në kërkesën e mareshalit osman për të pranuar dorëzimin e Plavës dhe të Gucisë, ai iu përgjigj :”Pasha hazretleri, jo ti, por edhe vetë sulltani të vijë këtu ne nuk do t’i dorëzojmë tokat që na i kanë lënë amanet stërgjyshërit tanë.”⁷⁰ Mehmet Ali pasha, duke parë se me të mirë nuk do të jetë në gjendje të bindë përfaqësuesit gjakovarë, e ndërroi tonin e bisedës dhe e kërcënoi Ahmet efendi Koronicën se po të vazhdonte të fliste në atë mënyrë “do ta dërgonte duarlidhur në Stamboll.” Por kadiu trim i Gjakovës, pa iu trembur syri ia ktheu si nëpër flakë: ”Pashë, pashë, shiko se mos të dërgojmë ne ty duarlidhur.”⁷¹ Përgjigje të njëjtë mori pashai osman edhe nga Ali pashë Gucia, nga i cili kërkoi që të shpërndante forcat e armatosura. Por, ai iu përgjigj se kurrë nuk do ta bënte këtë tradhti dhe e pyeti :”Çfarë do ti këtu, cilin ke pyetur ti që po ua dorëzon këto troje dushmanëve tanë, mos po jep tokat tuaja?”⁷²

Gjatë bisedimeve të ashpra që po zhvilloheshin në sarajin e Abdullah pashë Drenit, jashtë mureve të tij u mblodhën shumë njerëz, të “nxitur së tepërmi kundër pashës nga kadiu Ahmed Hamdi efendiu...duke share “murtad”(tradhtar), kështu që ai u detyrua të hyjë brenda.”⁷³ Ata, pas mbarimit të takimit me përfaqësuesin e sulltanit, hynë me forcë brenda dhe kërkuan nga pashai i Gjakovës që ta kthejë mysafirin e tij, të urrejtur nga populli, kah kishte ardhur brënda 24 orësh. Por Abdullah pasha refuzoi kërkesën e tyre, duke u mbështetur në zakonin e mikpritjes shqiptare. Sipas Ymer Shabës, kushtimin për rrethimin e pallatit të Abdullah Drenit e dha Ahmet efendi Koronica, i cili shkrefi pesë herë allti në ajr.⁷⁴ Pas tij filluan të shtënat “tue bertitë sa me t’a shti mëneren” për disa orë “vetem në mure e pullaze.”⁷⁵ Pas kalimit të afatit të ultimatimit prej 24 orësh filloi lufta e vërtetë me shumë viktima nga të dy palët, të cilat qëlltoheshin nga frengjitë e sarajit të Abdullah pashës, nga njëra anë dhe nga minareja e Xhamisë së Kyepazarit prej nga shtinin luftëtarët e Krasniqës, nga minareja e Xhamisë

⁶⁹ K. Frashëri, LSHP I. 253. Xh. Belegu, Lidh. e Priz. 50.

⁷⁰ Ibid.

⁷¹ Ibid.

⁷² J. Hadži- Vasiljević, Arb. Liga. 55. K. Frashëri, LSHP I. 254.

⁷³ Dr. Hofmani, Jelinekut, Prizren, 15 shtator 1878. AIHT.

⁷⁴ M. Paci, Ali pashë Gusija. 311. K. Frashëri, LSHP I. 254.

Anonimi gjakovar na jep një variant tjetër:”Ni sahat mbasi ka ik Hasan Aga (nga saraji i Abdullah Drenit-MR), Nuz Dubova, zaptia i Hasan Ages, ka zhpras pistolin per tok tuj than, “Hiç, djal, me msy sarajin, se te presim murtatin” (Mehmet Ali pashën-MR). E u nis pushka herën e parë.”

⁷⁵ Jelineku, Andrashit, Prizren 7 shtator 1878. AIHT. Leka. 551. K. Frashëri, LSHP I. 254.

së Islam begut, ku luftonin vullnetarët e Gashit dhe nga kulla e Sylejman Vokshit, prej nga shuinin luftëtarët e tij nga ana tjetër. Burimet e shumta dhe tradita popullore sjellin hollësi të llojloshme, shpesh kundërtëse, rreth këtyre ngjarjeve. Ne do të kufizohemi vetëm në të dhënat nga raporti i mjekut austriak nga Prizreni Dr Hofman, të cilat, sipas mendimit tonë, janë më realat: "Shkaktari kryesor i kësaj skene tragjike, kadiu Ahmet Hamdi efendiu, një Haxhi Llojë i dytë (prijës i kryengritjes kundër pushtimit austro-hungarez të Bosnjës dhe Hercegovinës-MR), i cili për këtë qëllim shkoi në Gjakovë dy ditë para nisjes së Mehmet Aliut, e nxiti tejmasë popullin e ulët (vegjelinë-MR) me të gjitha mjetet që kishte në dispozicion, ai ishte kudo dhe askund. Me urdhërin e tij populli solli disa qerre me sanë e kashtë, i vuri ato rreth e rrotull banesës së pashës, pasi më përpara, njerëzit patën hudhur mbi çatinë e kullës batanie, çarçafë etj. në sasi të madhe të lyera me vajguri. Materiali i djegëshëm u ndez, hatllat e çatisë morën zjarr, që u përhap deri brenda ndërtesës. Gati të mbytur nga tymi dhe nxehtësia njerëzit e shumë që gjendeshin në kullë vrapuan përjashta. Kushdo që dilte vritej."

"Mehmet Aliu i plagosur në kofshën e djathtë, lidhi në një shkop një pëlhurë të bardhë, duke ia treguar popullit me shpresë se ndoshta do të shpëtojë akoma në çastin e fundit, por pa sukses. Me flamurin e bardhë në dorë dhe duke thirrur "La ilahe ill" Allahi, ve Mohamed resul Allahi" u vërsul përjashta. Ai u prit me një breshëri plumbash dhe u plandos në këmbët e gjakësve të tij me gjoksin e hapur të shpuar si një shoshë."⁷⁶

Luftimet kundër mushirit osman vazhduan, me disa ndërprerje, deri më 6 shtator 1878, kur u vranë Mehmet Ali pasha, Abdullah pashë Dreni, Bajram agë Rustemi, Shaqir agë Curri etj. Numri i përgjithshëm i të vvarëve arrinte përafërsisht në 400, ndërsa i të plagosurve në 700.⁷⁷

Të përmendim, me këtë rast, se gjatë këtyre ngjarjeve, luftëtarët shqiptarë çarmatosën afro tri batalione nizamësh osmanë dhe me armët e zëna armatosën rreth 1800-2400 bashkëluftëtarë të tyre me pushkë të sistemit "Martini-Henri," model 1871.⁷⁸

Misioni i Mehmet Ali pashës dhe fundi tragjik i tij lanë vrragë të thella në Shqipëri dhe në arenën ndërkombëtare. Këtë mision e ndoqën me kujdes, që nga fillimi, si përfaqësuesit diplomatikë të Fuqive të Mëdha, nënshkruese të Traktatit të Berlinit, ashtu edhe korrespondentët e ndryshëm të shtypit, në radhë të parë, të atyre shteteve që kishin interesa të drejtpërdrejta në

⁷⁶ Dr. Hofman, Jelinekut, Prizren, 15 shtator 1878. AIHT.

⁷⁷ Cf. K. Frashëri, LSHP I. 258.

⁷⁸ Riza T. Drishti, Problemi i armatimit në luftën e Lidhjes Shqiptare të themeluar në Prizren në vitet 1878-1881. Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881. II. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë 1981. 250.

Shqipëri. Prandaj, fill pas kësaj vrasjeje u bënë shumë analiza rreth shkaqeve të dështimit të këtij misioni, rreth frymëzuesve dhe organizatorëve të revoltës së shtatorit, rreth karakterit, rreth autorëve të saj etj.

Përfaqësuesit diplomatikë austro-hungarezë, të njërit nga shtetet me interesa të posaçme në Shqipëri, e ndoqën me kujdes misionin e të dërguarit të sulltanit. Disa prej tyre i kishte përfshirë një panik i panevojshëm pas kësaj tragjedie. Kështu, Jelinek kërkonte nga ministri i tij i Jashtëm që, për gjendjen e vështirë të krijuar pas vrasjes së Maxharr pashës, të merreshin masa mbrojtëse për konsullatën e tij, për te, për familjen e tij dhe për klerin dhe të krishterët. Prandaj, sipas tij, “janë të nevojshme masa të ngutshme...duke bërë përgjegjës personalisht Ahmet efendi Koronicën, krerët e arnautëve gjakovarë e pejanë, ata të Dibrës në personin e Iliaz pashës, që gjindet këtu (në Prizren-MR), Hasan pashës së Kalkadelenit (Tetovës-MR), Dërvish beut të Lumës...si dhe valiut Nazif pasha e mytesarifit Qamil beu për çdo akt dhune cilido qoftë autori dhe viktima...”⁷⁹ Nën ndikimin e tij ishte edhe eprori i tij, Andrashi, i cili, nëpërmjet ambasadorit të vet në Londër, kontit Deym, kërkon nga ministri i Punëve të Jashtme të Anglisë, Solsberi, të përkrahë kërkesën e Vjenës drejtuar Stambollit për marrjen e masave kundër shkatërrtarëve të gjakderdhjes në Gjakovë. Me këtë rast ai përmend si “udhëheqës dhe autorë të trazirave në Shqipëri dhe si nxitës të vrasjes së Mehmet Aliut” udhëheqësit shqiptarë Ahmet efendi Koronicën, Iljaz pashë Dibrën, Hasan pashë Tetovën, Dervish bej Lumën, valiun e Prishtinës Nazif pashën dhe mytesarrifin e Prizrenit, Qamil beun.⁸⁰

Natyrisht, valiun e Kosovës dhe mytesarifin e Prizrenit nuk mund të fajësoheshin për dramën e Gjakovës. Ata, sipas Jelinekut, të frikësuar deri në palcë, fajësoheshin për masat e pamjaftueshme për mbrojtjen e tij dhe të konsullatës austro-hungareze në Prizren.⁸¹ Nga burime të tjera, sidomos nga dëshmitarët e drejtpërdrejtë të këtyre ngjarjeve, del se frymëzuese e ngjarjeve të shtatorit në Gjakovë ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit, ndërsa organizatore e tyre Dega e saj në Gjakovë. Ndër udhëheqësit kryesorë që iu prinë këtyre ngjarjeve ishin: Ahmet efendi Koronica, Sylejman agë Vokshi, Ali pashë Gucia, Jakup Feri, Ismail efendiu, myderrizi i Medresesë së Madhe dhe krerët e esnafëve të qytetit.⁸²

⁷⁹ Jelineku, Andrashit, Prizren, 10 shtator 1878. AIHT. Leka 555. Kryekonsulli G.F. Chiari, Andrashit, Selanik, 14 shtator 1878. AIHT.

⁸⁰ Andrashi, kontit Deym, Vjenë, 15 shtator 1878. LSHP në dok. ang. 96-97. Cf. K. Frashëri, LSHP I.258, 265.

⁸¹ Cf. K. Frashëri, LSHP I. 258.

⁸² Anonimi gjakovar fq. 1. Vrasja e Mehmet Ali pashës. “Fjamuri i Arbërit,” Corigliano Calabro, nr. 1, 20 korrik 1883. Artikull i redaksisë. Mendimi politik e shoqëror i

Vrasjen e Mehmet Ali pashës e shikuan me sy të ndryshëm forcat politike brenda Lidhjes Shqiptare. Qarqet sulltaniste mendonin se me këtë akt Lidhja kishte bërë një hap të pamatur, që e kishte kthyer Portën e Lartë kundër saj. Prandaj, të pakënaqur me një hap të tillë, ata u shprehën haptas kundër krerëve të Lidhjes Shqiptare. Konflikti i mundshëm midis Portës dhe Lidhjes i shqetësonte edhe qarqet e moderuara brenda saj, sepse kjo sjellje shkonte në favor të armiqve të popullit shqiptar – të shteteve fqinje ballkanike, pikërisht në kohën kur po qarkullonin lajmet mbi qëllimet e Austro-Hungarisë për vendosjen e trupave të saja në Sanxhakun e Jeni Pazarit. Kësodore, Lidhjes i kërcënohej rreziku i përçarjes së brendshme, rrezik të cilin e nxitën Ali pashë Gucia dhe Ahmet efendi Koronica, të cilët formuan “Lidhjen e re” në Gjakovë dhe kërkuan nga komitetet krahinore të Kosovës, të Dibrës dhe të Shkodrës t’i ndërprisnin lidhjet me qendrën në Prizren dhe t’i bashkoheshin Gjakovës.⁸³ Dr. Hofman kishte marrë një lajm nga Gjakova, sipas të cilit “krerët e shqiptarëve të Gjakovës, Pejës, Gucisë dhe Plavës u mbledhën me ata të malësorëve në Jabllanicë, katër orë larg prej Gjakovës kah Peja.” Qëllimi i mbledhjes, të cilën e kryesonte Ahmet efendi Koronica, mbahej i fshehtë, por sipas lajmeve që qarkullonin, pjesëmarrësit e saj “duan ta prishin besën e lidhur me Prizrenin, mbasi Prizreni nuk dëshironte të marrë bashkërisht përgjegjësinë për ngjarjet e Gjakovës.”⁸⁴ Ali pashë Gucia dhe Ahmet efendi Koronica nuk pajtoheshin me qëndrimin e Lidhjes Shqiptare, e cila orvatej të evitonte konfliktet e reja me Stambollin pikërisht në kohën kur rrezikoheshin tokat shqiptare nga shtetet fqinje ballkanike. Sipas tyre duhej shfrytëzuar pozita superiore e Lidhjes ndaj monarkive ballkanike dhe Portës së Lartë, e krijuar pas ngjarjeve të Gjakovës. Po të mos shfrytëzohej ky rast i volitshëm, i krijuar nga entuziazmi që kishte përfshirë pothuajse të gjitha shtresat e popullsisë, atëherë kjo pozitë do të ndryshonte në disfavor të shqiptarëve dhe të integritetit territorial të tyre. Për këtë arsye, mendonin ata, shqiptarët duhej të

Rilindjes Kombëtare Shqiptare (Përmbledhje artikujsh nga shtypi), Vëllimi I. Tiranë 1971.175. K. Frashëri, LSHP I.259. Xh. Belegu, Lidh. e Priz. 50. J. Hadži-Vasiljević, Arb. Kongra. 59.

⁸³ “Istok,” 28 shtator 1878. Lippih, Andrashit, Shkodër, 21 shtator 1878. AIHT. K. Frashëri, LSHP I. 267. Cf. Raport i Jelinekut, Andrashit, Prizren 12 shtator 1878. AIHT.

Komiteti i Lidhjes në Shkodër, sipas Lipiçit, kishte “dërguar në Gjakovë një delegat në personin e Jusuf efendiut ku, sipas lajmeve të ardhura këtu (në Shkodër-MR), Liga e Prizrenit pas shpërndarjes gjoja të Komitetit Qendror dhe shpërndarjes së saj nga qarqet që morën pjesë në vrasjen e Mehmet Aliut, qenka formuar rishtas.” Lippih, Andrashit, Shkodër 21 shtator 1878. AIHT.

⁸⁴ Relacion i Dr. Hofmanit, Jelinekut, Prizren, 17 shtator 1878. Jelineku, Andrashit, Prizren, 15 shtator 1878. AIHT.

sulmonin të parët kundër ushtrive malazeze dhe, pas kësaj, edhe kundër ushtrive serbe për të zgjidhur në favor të tyre çështjen e kufijve, duke mos përfillur qëndrimin e Stambollit ndaj kësaj çështjeje. Ata shprehnin gatishmërinë e tyre edhe për ndonjë konflikt eventual me Portën.⁸⁵

Në këtë kuadër Ali pashë Gucia mori masa konkrete për fillimin e operacioneve luftarake kundër Malit të Zi. Më 14 shtator 1878 e njoftoi Komitetin e Lidhjes në Shkodër se kishte grumbulluar 30 mijë luftëtarë, të gatshëm për të sulmuar Malin e Zi. Ai ishte i bindur se, në bazë të marrëveshjes së mëparshme, edhe shkodranët me malësorë ishin të gatshëm për luftë.⁸⁶

Mendimet e Ali pashë Gucisë dhe të Ahmet efendi Koronicës mbi një fitore të mundshme në një përlëshje eventuale midis shqiptarëve dhe malazezve e kishin njëfarë mbështetje në rrethanat konkrete të kohës, të cilat i përshkruajnë disa vëzhgues të huaj. Kështu, bie fjala, konsulli francez në Shkodër G. Pons, duke raportuar për përpjekjet e valiut, Hysen pashës, për t'i bindur krerët e malësive që t'i ndërrojnë kullotat e tyre dimërore të Ulqinit me kullotat që ai u ofronte në rrethet e Lezhës dhe të Tiranës, shprehte bindjen se “fiset që zotërojnë toka prodhuese në rrethin e Ulqinit nuk do të mungojnë të rimarrin vendet e tyre të dimërimit.”⁸⁷ “Qëndresa që po gjen ushtria austro-hungareze në Bosnje – vazhdon më tej – u jep shumë shpresë anëtarëve të Lidhjes Shqiptare, të cilët pretendojnë se, duke qenë më të shumtë dhe po aq të vendosur si edhe boshnjakët, ata do të mund jo vetëm të përballojnë çdo sulm të Malit të Zi, por edhe ta sulmojnë këtë edhe Serbinë.”⁸⁸ Konsulli anglez në Shkodër kishte pikëpamje të ngjashme me

⁸⁵ Cf. K. Frashëri, LSHP I. 267.

⁸⁶ Engjëll Çoba, Stef Biankit në Venedik, Shkodër 15 shtator 1878. Dhimitër Andoni-Kolë Luka, Burime të reja vendëse mbi periudhën e Lidhjes së Prizrenit. Studime historike 3, Tiranë 1968. 129. K. Frashëri, LSHP I. 267. Grini, Solsberit, Shkkodër 15 shtator 1878. Arkivi i Kosovës.

“Mbi përgjigjen që i dhanë këtu Ali pashës lidhur me propozimin e tij, për t'i bashkuar forcat e armatosura të këtushme me ato të Ligës së re për një sulm kundër Malit të Zi akoma nuk është marrë vesh asgjë.” Cf. Raport i Lippih-it, Andrashit, Shkodër, 21 shtator 1878. AIHT.

⁸⁷ Ponsi, Vadingtonit, Shkodër, 1 tetor 1878. Shqip. në vitet e LSHP I. 202.

⁸⁸ Op. cit. 203.

Duke krahasuar qëndresën shqiptare me atë boshnjake, gazeta “Journal de Debat” shkruan : “Midis kryengritjes së boshnjakëve dhe asaj të shqiptarëve ka një ndryshim; boshnjakët janë shtytur kryesisht nga fanatizmi fetar, kurse shqiptarët janë të mbuluar nga ndjenja e kombësisë dhe nga sedra kombëtare...Prandaj nuk mund të mendohet që ata t'u nënshtrohen Serbisë e Austrisë. Shqiptarët janë më trima, më guximtarë, më të lirë e më aktivë se të gjithë popujt e Lindjes. Ata që patën shfaqur mendimin më të lirë në mexhlisin e deputetëve në Stamboll, qenë

kolegun e tij francez. Ai pohonte se “do të ishte një gjë me mend që Lidhja Kombëtare Shqiptare ta ndërmirte një fushatë kundër Malit të Zi fuqitë e të cilit duke mos mundur t’u qëndrojnë sulmeve shqiptare, patjetër do të detyrohen të tërhiqen...”⁸⁹

Të përmendim, me këtë rast, se Mali i Zi ishte në një gjendje të vështirë ushtarake dhe ekonomike. Në luftën kundërosmane knjaz Nikola gëzonte përkrahjen e plotë të luftëtarëve trima të Hercegovinës, të cilët, që në fillim të Krizës Lindore më 1875 kërkonin bashkimin me Malin e Zi. Por, me kërkesën e Austro-Hungarisë, Mali i Zi u detyrua të çarmatoste ushtrinë e Hercegovinës.⁹⁰ Aspak më e mirë nuk ishte gjendja ekonomike-financiare e Malit të Zi. Ndihmën e rregullt financiare prej 20 mijë fiorinash, të cilën ia dërgoi Rusia për muajt korrik, gusht, shtator dhe tetor, në terësi e kishte borxh qeveria e Malit të Zi.⁹¹

Do theksuar se “Lidhja e re” në krye me Ali pashë Gucinë dhe Ahmet efendi Koronicën kishte mjaft përkrahës në krahina të ndryshme të Shqipërisë, në radhë të parë në Gjakovë, në Shkodër dhe në Dibër, ku i kishte mbështetësit e saj më të flaktë. Konsulli austro-hungarez në Shkodër, ndër të tjera, shkrua-nte: “Duket se këtu në Shkodër ata që duan të formojnë një parti ekstremiste të lidhur me Ali pashë Gucinë dhe me Ahmet efendi Koronicën, mendojnë se Porta nuk do të rrijë pa ndërhyrjen e saj hakmarrëse ndaj shqiptarëve,,, Unë ende besoj se Ali pashë Gucia...ka synimin që t’i jape Lidhjes (së re-MR) së themeluar prej tij relievin e një kokëforti, duke ngulur këmbë për t’u kthyer në programin fillestar të Lidhjes.”⁹²

Përfaqësuesit e “Lidhjes së re,” siç del nga disa lajme të disa gazetave të Vjenës, filluan të ndëmirnin masa konkrete për realizimin e platformës së tyre politike. Sipas disa korrespondencave nga Prizreni, të një pjese të shtypit vjenez, më 4 tetor 1878 qarkullonin lajmet “se në Gjakovë do të shpallej *princi shqiptar*, i cili do të jetë krejtësisht i ndarë dhe pa kurrfarë

deputetët shqiptarë.” “Terxhymani Shark,” 10 shtator 1878. Sami Frashëri, Vep-ra I.Tiranë 1988.212.

⁸⁹ Grini, Sosberit, Shkodër, 15 shtator 1878. Arkivi i Kosovës

⁹⁰ Qeveria e Malit të Zi i mbante, në periudhën gusht – fund i tetorit 1878, në Grahovë 145 krerë hercegovinas, të cilët i kishte bindur që ta pranonin pa kurrfarë kundërshtimi okupimin e vendit të tyre nga ushtria austro-hungareze. Më 6 tetor 1878 në Goričko Polje, afër Trebinjës, iu dorëzuan gjeneralit austro-hungarez 3500 ushtarë dhe eprorë vetëm të një pjese të ushtrisë së Hercegovinës. Kjo shkaktoi tmerr midis tyre. Dr. Novak Ražnjatović, Crna Gora i Berlinski Kongres. Cetinje, 1979. 105.

⁹¹ Sipas Ražnjatovićit, “Në një gjendje të tillë të përgjithshme Mali i Zi ishte i detyruar të koncentrohej vetëm në përpjekje paqësore për marrjen e Podgoricës.” N. Ražnjatović, C. Gora i Berl. Kongres. 113.

⁹² Lippih, Andrashit, Shkodër, 21 shtator 1878. AIHT. K. Frashëri, LSHP I. 268.

lidhjeje me Turqinë.”⁹³ Këto lajme paraqisnin, sipas shtypit të përmendur, kundërshtimet e hapura ndaj sundimit të deritashëm osman. Kjo atmosferë ishte krijuar kur në Kosovë “u bë e ditur se sulltani në Stamboll pak me dëshirën e tij dhe pak nën ndikimin e rrethanave është i detyruar t’ia dorëzojë Malit të Zi Podgoricën dhe Shpuzën dhe, kësodore, *tokat shqiptare* (nënvizoi-MR) të bien nën administrimin e huaj.”⁹⁴ Prandaj, sipas këtyre lajmeve, çetat e Lidhjes Shqiptare do ta kontrollonin rrugën Pejë-Prizren, do të vendoseshin sa më shpejt 10-15 mijë ushtarë të Lidhjes në vijën Prishtinë-Pejë-Gjakovë⁹⁵ për ta kundërshtuar hyrjen e Osman pashës në Shqipërinë Veriore⁹⁶ dhe do t’u bëhej thirrje trupave të rregullta ushtarake për t’iu bashkuar shqiptarëve. Këto vendime, të cilat tanimë kishin filluar të realizoheshin në praktikë, çonin, sipas këtyre gazetave, në konflikt me Greqinë, me Malin e Zi dhe me vetë Portën, e cila mendonte ta nënshtrohte Lidhjen.⁹⁷ Megjithatë, Porta nuk e kishte lehtë ta nënshtrohte Lidhjen Shqiptare, sepse, sipas të dhënave që sjell gazeta e Beogradit “Istok”, “në ndihmën e garnizonit të Kosovës, i tillë siç është dhe sa është sot, vështirë mund të llogaritet. Për më tepër të gjithë ata që janë boshnjakë dhe shqiptarë në këtë ushtri, më parë do të nxitonjë të jenë nën flamurin e Lidhjes, se sa të provojnë të luftojnë kundër saj: kurse ajo (ushtri-MR) që do t’i mbetet “besnike sulltanit” do të jetë e detyruar ta kthejë shpinën. Flamujt e mosnënshtimit ndaj sulltanit tanimë janë ngritur. Na presin ditë të rëndësishme.”⁹⁸

Megjithë krijimin e një atmosfere të tillë pas ngjarjeve të Gjakovës, shumica e krerëve të Lidhjes Shqiptare nuk e miratonte programin politik të rrymës së “ekstremistëve,” e cila filloi të vepronte në mënyrë të pavarur me qendër në Pejë.⁹⁹ Grupi fare i vogël i rrymës së sulltanistëve në Lidhje kërkonte respektimin e urdhërave të Stambollit, zbatimin e Traktatit të Berlinit ndaj Malit të Zi dhe dërgimin e forcave të Lidhjes në Sanxhakun e Jeni Pazarit për ta mbrojtur nga pushtimi austro-hungarez, ndërsa rryma e të

⁹³ “Istok,” Beograd, 11 tetor 1878. “Srpske novine,” Beograd, 11 tetor 1878.

Lidhur me gjendjen e krijuar konsulli i Prizrenit, ndër të tjera, raporton: “Në Gjakovë u shpall një qeveri e përkohshme. Nëse një bashkëpunim i trupave tona për vendosjen e qetësisë në Gjakovë dhe Pejë, eventualisht në marrëveshje me qeverinë e Portës duke formuar një korpus vrojtimi në kufijtë e atyre rrethëve do të ishte i përshtatshëm, varet nga gjykimi i mençur i Qeverisë së Vjenës”. Jelineku, Andrashit, Prizren, 12 shtator 1878. AIHT.

⁹⁴ Ibid.

⁹⁵ Ibid.

⁹⁶ “Srpske novine,” 6 tetor 1878.

⁹⁷ “Srpske novine,” 13 tetor 1878.

⁹⁸ “Istok,” 11 tetor 1878.

⁹⁹ K. Frashëri, LSHP I. 268.

maturve mbronte tezën e ruajtjes së terësisë tokësore të trojeve shqiptare, por kërkonte mënjanimin e çfarëdo konflikti me shtetet fqinje ballkanike që do të shkaktonte ndërlikime në arenën ndërkombëtare në dëm të çështjes shqiptare dhe që do të acaronte marrëdhëniet me Portën e Lartë. Rryma e tretë, e cila nuk e miratonte as programin politik të sulltanistëve, as atë të të moderuarve kishte përqafuar platformën politike të Komitetit të Stambollit, të miratuar menjëherë pas vrasjes së Mehmet Ali pashës. Këtë platformë e trajtuan publikisht në shtyp Abdyl Frashëri, Pashko Vasa dhe Sami Frashëri, të cilët përcaktuan prioritetet e luftës së Lidhjes Shqiptare që ishin: kërkesa për themelimin e vilajetit të përbashkët autonom shqiptar me gjuhë zyrtare shqipen, me një qeverisje demokratike, që do t'u garantonte barazinë të gjithë qytetarëve pa dallim feje, klase apo kombësie, me buxhet të vetin që do të përdorej për ngritjen ekonomike, arsimore, kuturore me ushtri të veten etj. Këto synime arriheshin, sipas tyre, duke evituar kryengritjen e armatosur antiosmane, e cila, në ato çaste, ishte e parakohshme.¹⁰⁰

Pikëpamjet e ndryshme politike rreth detyrave imediate të Lidhjes Shqiptare shkaktojnë një diskutim të gjerë që u përhap në të gjitha viset e Shqipërisë. Disa vëzhgues të huaj këtë diskutim e paraqitën si rivalitet, apo, në disa raste, konflikt midis Gjakovës dhe Prizrenit. Gjakova, sipas tyre, ishte përfaqësuese kryesore e rrymës së ekstremistëve, ndërsa Prizreni përfaqësues zyrtar i rrymës së moderuar, ndonëse as që të gjithë gjakovarët as që të gjithë prizrenasit nuk ishin përkrahës të rrymave që mbanin emrat e qyteteve të tyre. Rryma e Prizrenit, e përkrahur gati nga të gjithë anëtarët e Komitetit Kombëtar të Lidhjes Shqiptare, mbështetej në platformën politike të Komitetit të Stambollit. Gjatë diskutimit që zgjati më tepër se dy muaj, shumica e qarqeve të moderuara përqaftuan platformën e Komitetit të Stambollit, ndërsa rryma “ekstremiste,” e cila, në filim, pati disa suksese të shpejta mbeti e izoluar.¹⁰¹ Në fund të shtatorit Lipiçi raportonte se Dibra, Tetova dhe Luma u shpëputën nga komitetet revolucionare të Gjakovës dhe u bashkuan, përsëri, me Prizrenin.¹⁰²

Mosmarrëveshjet midis dy rrymave u thelluan edhe më tepër rreth çështjes së fandëve, të cilët e mbrojtën Maxharr pashën në Gjakovë. Ahmet efendi Koronica me përkrahësit e tij mendonin se Lidhja duhej t'i denonte

¹⁰⁰ Më gerësisht : K. Frashëri, LSHP I. 268-270.

¹⁰¹ K. Frashëri, LSHP I. 271.

Sipas konsullit anglez, “gjatë disa mbledhjeve të mbajtura nëpër krahina të ndryshme si në Prizren, Dibër, Tiranë dhe nëpër disa rajone të Shqipërisë së Jugut, janë marrë vendime të rënda deri edhe denime me vdekje të disa personave, të cilët kanë refuzuar të ndahen nga autoritetet turke...” Grini, Solosberit, Shkodër, 15 qershor (?) 1878. Arkivi i Kosovës.

¹⁰² Lippih, Andrashit, Shkodër, 29 shtator 1878. K. Frashëri, LSHP I. 271.

rreptë fandët, të cilët, në mbrojtje të mareshalit osman, kishin vrarë vëllezërit e tyre dhe kishin shkelur besën e shpallur në qershor. Në raste të tilla Komiteti i Lidhjes Shqiptare parashikonte pushkatim për trathti të lartë. Por, nga ana tjetër, Komiteti Kombëtar i Lidhjes Shqiptare e kundërshtonte kategorikisht një masë të tillë kundër fandëve që shpëtuan në Gjakovë, sepse një masë e tillë do të hapte serinë e hakmarrjeve të pandërprera që do të dëmtonin vetë Lidhjen Shqiptare.¹⁰³ Prandaj, përfaqësues të Lidhjes nga Prizreni shkuan në Fand për t'u ofruar fandëve, në rast se shpërngulën nga Gjakova, një vend tjetër për t'u vendosur "vetëm se t'i ipet fund kësaj grindjeje vëllazërore."¹⁰⁴

Çështja e pozitës së vështirë të fandëve të Novo Sellës, mbrojtësve të mareshalit osman, zë një vend të rëndësishëm në raportet e përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Shqipëri, veçanërisht në raportet e diplomatëve austro-hungarezë, të cilët, për shkak të interesave të qeverisë së tyre në Shqipëri, nuk kishin qëndrim të drejtë ndaj veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare në përgjithësi dhe tragjedisë së Gjakovës në veçanti. Për të gjitha ngjarjet para dhe pas misionit të Mehmet Ali pashës, ata fajësojnë Ahmet efendi Koronicën, të cilin e konsiderojnë armik të të krishterëve. Në një raport të Jelinekut lexojmë: "Fill pas vrasjes së Mehmet Aliut Koronica i ndërseu myslimanët kundër katolikëve (fandëve) dhe në përgjithësi kundër të krishterëve dhe shpalli botërisht se mund të godasë pa druajtje, se paskësh të mbuluar shpinën, paskësh udhëzimet e veta prej Stambolli dhe për gjithçka do të përgjigjej. Kërditë, gjithashtu, do të kishin filluar sikur myftiu i Gjakovës dhe disa tribu malësorësh myslimanë nuk do ta kishin kundërshtuar projektin e çmendur, të poshtër."¹⁰⁵ Ai tregon më tutje se zemërimi kundër fandëve u shtua pas vrasjes së 450 myslimanëve që kishin rrethuar sarajin e Abdullah pashë Drenit. Sipas këtij raporti, "vetëm një fand (Hoshi i Nurit-MR) i vrau prej kulle (të Abdullah pashës-MR) 43 myslimanë, duke thirrur përpara çdo të shtëne me emër viktimën e zgjedhur."¹⁰⁶ Por, duke parashtruar argumentet për nevojën e mbrojtjes së tyre nga ana e qeverisë austro-hungareze, ai zbulon se urrejtja ndaj fandëve të Novo Sellës nuk mbështetej në fanatizmin fetar të Ahmet efendi Koronicës dhe të përkrahësve të tij, por në qëndrimin e gabuar politik të tyre, qëndrim që, sipas mendimit të Lidhjes, dëmtonte interesat kombëtare. Ndër të tjera, ai raporton: "Pasi që 500-600 familje që numërojnë fandët (e Novo Sellës-MR) janë treguar përherë si strehë, si mbështetje e fortë e

¹⁰³ K. Fashëri, LSHP I. 271.

¹⁰⁴ Grini, Solsberit, Shkodër, 7 tetor 1878. Ark. i Kosovës.

¹⁰⁵ Jelineku, Andrashit, Prizren, 21 tetor 1878. AIHT. Leka. 562-563.

¹⁰⁶ Ibid.

patundur e katolikëve të vendit dhe të kësaj konsullate (austro-hungareze në Prizren-MR) përherë i kanë qëndruar besnikë, po marr lejen t'ia rekomandoj ata mbrojtjes së fuqishme dashamirëse të Shkëlqesisë Suaj (Andrashit-MR), duke ia lënë gjykimit të urtë të Shkëlqesisë Suaj që të ketë mirësinë të ndërhyjë pranë qeverisë së Portës në mënyrë që ata të mos kërcënohen dhe të ndiqen prej myslimanëve të Gjakovës.”¹⁰⁷ Duke vazhduar më tutje ai pohon se fandët nuk ishin vetëm përkrahës të Austro-Hungarisë, por edhe shërbëtorë besnikë të sulltanit: ”Fandët i qëndruan përherë besnikë Portës, përherë përpara të gjithë të tjerëve vajtën si bashibozukë, së fundit si mbrojtës të Mehmet Aliut kanë rrezikuar jetën e tyre për një funksionar të lartë të shtetit dhe të dërguarit të M.T. Sulltanit, pra kanë plotësisht të drejtë për një mbrojtje energjike të qeverisë së Portës.”¹⁰⁸ Edhe në raportet e mëvonshme Jelinek e trajtonte në mënyrë alarmuese çështjen e fandëve, pasigurinë e të cilëve u orvat ta shfrytëzojë për interesa të veta edhe Serbia, e cila nuk kishte treguar kurrfarë mirëkuptimi ndaj katolikëve shqiptarë në Sanxhakun e Nishit.¹⁰⁹ Ai raporton, pos tjerash, edhe këtë: ”Në vend që t'u dorëzoheshin armët muhamedanëve, që fandasit e konsiderojnë si gjenë më të turpshme, ata patën vendosur më mirë të emigrohej në Serbi, e cila atyre u kishte ofruar kondita shumë të favorshme për kolonizim, sikundër më siguruan disa priftër katolikë dhe vetë fandasit.”¹¹⁰ Por, ashtu si në raportet e mëhershme, është i detyruar të pranojë se fandët e Novo Sellës gëzonin mbrojtjen e miqve të tyre myslimanë të Gashit, të Hasit e të Krasniqes.¹¹¹

Sipas Jelinekut, Ahmet efendi Koronica kërkonte çarmatosjen e fandëve, të cilët do të punonin si rajë në fortifikatën e qytetit me të cilën do ta rrethonte Gjakovën ose duhej t'i lëshonin trojet e veta dhe të ktheheshin në Mirditë. ”Por fandët katolikë – vazhdonte më tutje – nuk duan ta pranojnë këtë alternativë meqë ende nuk dihej nëse fisi Gashi do të dorëzohej për

¹⁰⁷ Ibid.

¹⁰⁸ Ibid.

¹⁰⁹ Cf. Toger Roos i Blandesburgut, majorit Wilson, Selanik, 28 dhjetor 1878. Prof. Dr. Skënder Rizaj, Dokumente angleze mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe fillimin e copëtimit të Ballkanit (1877-1878) I. Prishtinë-Istanbul-Tiranë, 1993. 135. Më tutje: S. Rizaj, Dok ang mbi LSHP I.

¹¹⁰ Jelineku, Andrashit, Prizren 30 nëntor 1878. AIHT. Leka 572-573.

¹¹¹ Ibid.

Jelinek është më afër së vërtetës kur i raporton arsyet e pjesëmarrjes së tyre në anën e Maxharr pashës :”...Fandasit nga ana e tyre thonë dhe me plot të drejtë, se të 80 fandasit që mbrojtën mareshalin kishin bërë vetëm detyrën e tyre si vartës të shefave dhe eporëve të tyre të shërbimit të Avdullah pashës dhe Bajram agës, duke i mbrojtur ata me mikun e tyre Mehmet Ali pashën në saje të besës së dhënë, bile duke sakrifikuar jetën e tyre, sikundër i ka hije një shqiptari të vërtetë.” Op. cit. 574.

përzierjen e përgjakshme me Gjakovën.”¹¹² Natyrisht, kadiu i Gjakovës nuk pati sukses në kërkesat e tij falë qëndrimit të kundërt që morën krerët e fiseve të ndryshme të Malësisë së Gjakovës. Grini raporton se Ahmet efendi Koronica “nuk mundi t’ia dalë në krye për t’i larguar mirditasit e Fandit nga tokat që ata kishin pasë pushtuar në afërsi të Gjakovës për shkak se fiset e fuqishme myslimane të Krasniqit, si dhe të Gashit kanë deklaruar se ata do të qëndrojnë besnikë të lidhjes së vjetër me fiset katolike dhe se do të marrin pjesë në mbrojtjen e tokave të tyre.”¹¹³

Për shkak të përçarjeve politike që ekzistonin midis fraksioneve të ndryshme në radhët e banorëve të Gjakovës me rrethinë, si duket Ahmet efendi Koronica hasi në vështirësi edhe në misionin e tij për të gjetur mbështetje për një solidarizim me pjesëmarrësit e atentatit mbi Mehmet Ali pashën nëpërmjet “një deklarate të shkurtër ku thuhej se ai pat ekzekutuar dëshirat e mbarë popullsisë.”¹¹⁴ Sipas Lipiçit, këtë e bënte “për ta evituar izolimin e gjakovarëve,”¹¹⁵ (nga pjesët e tjera të Lidhjes Shqiptare- MR). Nënshkrimin e deklaratës së përmendur e pengoi edhe Jelinek, i cili, nëpërmjet kanalesh të veta, e këshilloi priftin katolik të Gjakovës Don Pjetër Dodën për të mos e nënshkruar “mazbatën” e kadiut të Gjakovës. Don Pjetri e lëshoi Gjakovën, por u kthye pasi mori lajmin se “mazbata” ishte dorëzuar në Stamboll.¹¹⁶

Marrëdhëniet ndërmjet rrymës së Gjakovës dhe asaj të Prizrenit arritën kulmin e acarimit kur rryma e Gjakovës ia dërgoi Komitetit Kombëtar një notë, me anën e së cilës e kërcënonte se po të ndahej nga “kauza kombëtare,” Prizreni do të sulmohej në fund të tetorit 1878, do të plaçkitesj dhe do të digjej.¹¹⁷ Për të qenë sa më të përgatitur për një përleshje eventuale ekstremistët e Gjakovës filluan ndërtimin e fortifikimeve “gjoja për t’u mbrojtur nga ndonjë sulm eventual austro-hungarez.”¹¹⁸ Grini, duke bërë fjalë për autoritetin e Koronicës, raportonte: “Kadiu (Ahmet efendi Koronica-MR), si dhe myftiu (Numan efendi Buza-MR) i Gjakovës, që tani janë de fakto guvernatorët e vendit, kanë dhënë urdhër për ndërtimin e fortifikatave rreth e për qark qytetit në mënyrë që ata të mund të mbrohen nga cilido rrezik që mund t’u vijë qoftë nga Bosnja në formë Austriake qoftë

¹¹² Lippih, Andrashit, Shkodër 7 tetor 1878. Ark. i Kosovës.

¹¹³ Grini, Solsberit, Shkodër 7 tetor 1878. Ark. i Kosovës.

¹¹⁴ Grini, Sosberit, Shkodër 7 tetor 1878. Ark. i Kos. CF. Lippih, Andrashit, Shkodër 7 tetor 1878. AK.

¹¹⁵ Lippih, Andrashit, Shkodër 7 tetor 1878. Ark. i Kos.

¹¹⁶ Jelineku, Andrashit, Prizren 30 nëntor 1878. AIHT. Leka. 572.

¹¹⁷ Grini, Solsberit, Rap. 75, Shkodër, 30 shtator 1878. K. Frashëri, LSHP I. 271.

¹¹⁸ K. Frashëri, LSHP I. 271.

nga Stambolli në formë Otomane.”¹¹⁹ Megjithatë, Komiteti Kombëtar i Lidhjes arriti të korrë fitore mbi ekstremistët gjakovarë. Udhëheqësit e tij arritën të qetësojnë palët e revoltuara që kërkonin hakmarrje pas vrasjeve në Gjakovë, të siguronin një besë deri në fund të tetorit me shpresë se do ta vazhdonin pas kalimit të këtij afati.¹²⁰ Nga ana tjetër, edhe Dega e Lidhjes Shqiptare në Pejë u nda nga grupi i ekstremistëve të Gjakovës dhe u bashkua me grupin e Prizrenit. Në një mbledhje që u mbajt në një vend diku midis Pejës e Gjakovës, e të cilën e kryesonte, si duket, vetë Ahmet efendi Koronica, “palët u fjalosën aq shumë sa që kadi Ahmet Efendi Koronicës iu desh, për të shpëtuar kokën, të kthehej me rrugë të tërthorta në Gjakovë, ku tani gjendet i mbyllur në shtëpine e vet.”¹²¹ Kësodore, fraksioni i Gjakovës, i mbledhur rreth “Lidhjes së re”, përfundoi së qeni terësisht. Ali pashë Gucia iu bashkua grupit të Prizrenit. Për Ahmet efendi Koronicën, Kristo Frashëri, njohësi më i mirë i Lidhjes Shqiptare, thotë se “kërkoj të transferohej si kadi në një vend tjetër duke u tërhequr dalngadalë nga jeta politike.”¹²²

Mirëpo, të dhënat që dalin nga burimet që kemi në dispozicion, sado që më të kufizuara, tregojnë të kundërtën. Prandaj, mendojmë se kadiu i Gjakovës nuk e ndërpreu tërësisht veprimtarinë e tij politike në kuadër të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ndonëse në periudhën e ardhshme, ndoshta, nuk gjendej në elitën politike të saj. Kështu, kur Sheh Mustafa Tetova, i liruar nga internimi, arriti në Kosovë, në përpjekjet e tij për riorganizimin e Lidhjes Shqiptare, vizitoi shumë qytete të ndryshme të Vilajetit të Kosovës dhe pati shumë takime me krerët vendorë. Në Gjakovë u takua me Ahmet efendi Koronicën më 12 tetor 1878. Sipas Jelinekut, “Sheh Mustafa është ndalur për banim te kadiu Ahmet efendi Koronica, mandej ka biseduar fshehurazi me dy myderrizët e mëdhenj, me myftiun dhe presidentin e mexhllisit Sylejman aga dhe qysh me mbërritjen e tij atje është përhapur edhe lajmi që qarkullon këtu, se pushtimi austro-hungarez do të shtrihet deri në Selanik, se duan t’i dërgojnë një deputacion valiut Nazif pasha për ta pyetur nëse edhe Shqipëria e Sipërme ndoshta është shitur, nëse valiut është me popullin apo kundër tij...”¹²³ Grini, i cili e quan kadiun e Gjakovës edhe më tutje “njeri me nam”, raporton se shehu i Tetovës “në Gjakovë ka rënë në konak te Kadri Koronica, duke qetësuar tragjedinë të bërë tani vonë.”¹²⁴ (vrasja e Mehmet Ali pashës-MR).

¹¹⁹ Grini, Solsberit, Shkodër, 7 tetor 1878. Ar. i Kos.

¹²⁰ Lippih, Andrashit, Rap. 95, Shkodër, 29 shtator 1878. K. Frashëri, LSHP I. 271.

¹²¹ Lippih, Andrashit, Shkodër, 7 tetor 1878. Ark. i Kos. K. Frashëri, LSHP I. 271-272.

¹²² K. Frashëri, LSHP I. 272.

¹²³ Jelineku, Andrashit, Prizren, 15 tetor 1878. AIHT. Leka. 559.

¹²⁴ Grini, Solsberit, Shkodër, 22 tetor 1878. LSHP në dok ang. 103. Cf. K. Frashëri, LSHP I. 275.

Ahmet efendi Koronica, bashkë me krerë të tjerë të Lidhjes, të mbledhur nga të gjitha anët, u tubuan në Prizren për të shqyrtuar gjendjen e krijuar pas lajmeve të përhapura mbi përgatitjet e ushtrisë austro-hungareze për pushtimin e Sanxhakut të Jeni Pazarit. Qëllimi kryesor i tyre ishte vajtja në Prishtinë për t'u këshilluar me valiun Nazif pasha rreth shqetësimit që kishin shkaktuar lajmet e përhapura. Toger i Roos i Blandesburgut, i cili na i sjell këto të dhëna, raporton se "mes tyre është edhe Korenica, i përmendur më parë, i cili ishte shkaktar i vdekjes së Mehmet Ali pashës." Toger i anglez, i cili e kishte takuar kadiun e Gjakovës në shtëpinë e valiut, vazhdon: "Vura re se u pranua mirë e më vonë e pashë përsëri me gjeneralin Nuri pasha."¹²⁵ Ai deklaroi se nuk arriti t'i zbulojë arsyet e vërteta të vizitës së krerëve të Lidhjes në Prishtinë, se bisedimet mbaheshin të fshehta. Por, sipas tij, qarkullonin lajmet "mu para bajramit (më 5 dhjetor) se serbët po e përqendronin ushtrinë në Kurshumli... e për këtë erdhën te vali i për arsye të ndihmës reciproke. Është e mundshme po ashtu, se prania e tyre ka të bëjë me lëvizjen austriake, në rast se synojnë të depërtojnë kah Jeni Pazari."¹²⁶

Oficeri anglez nuk e përmend ekskluzivisht pjesëmarrjen e sheh Mustafa Tetovës në bisedimet e Prishtinës. Por, nga analiza e terësishme e raportit të tij del se edhe ai ishte pjesëtar i grupit të krerëve të Lidhjes. Gjithashtu, nga burime të tjera del qartë se shehu i Tetovës ishte pjesëtar i delegacionit të Lidhjes te vali i Prishtinës.¹²⁷ Sido që të jetë, nuk jemi në gjendje të përcaktojmë marrëdhëniet politike të shehut të Tetovës me kadiun e Gjakovës. Ka mendime se sheh Mustafa Tetova nuk arriti të mirret vesh në Gjakovë me Ahmet efendi Koronicën.¹²⁸ Ky konstatim është plotësisht i mundshëm për vetë faktin se ata kishin pikëpamje krejtësisht të kundërta rreth detyrave që parashtrheshin para Lidhjes Shqiptare. Sheh Mustafa Tetova, i cili kishte përfaqësuar pikëpamjet e Komitetit të Stambollit vetëm përsa u përket të drejtave autonomiste, mendonte se për arritjen e tyre duhej bërë lëshime ndaj kërkesave të Stambollit për dorëzimin e Plavës dhe të Gucisë Mait të Zi, me kusht që të fitohej vilajeti shqiptar. Dihej se, asokohe, Porta, para se të përdorte forcën kundër Lidhjes, kishte premtuar se do ta

¹²⁵ Toger i Roos i Blandesgurgut, majorit Wilson, Selanik, 28 dhjetor 1878. Dok. ang. mbi LSHP I. 141.

¹²⁶ Ibid.

Haxhi-Vasileviq shkruan, në mënyrë tendencioze, se, pas vrasjes së Maxharr pashës, Porta dërgoi në Prizren Fazli pashën me 16 tabore ushtarë, kinse për t'i detyruar shqiptarët të dorëzonin Plavën dhe Gucinë. Por ai nuk bëri asnjë hap tutje. Madje "armët, të cilat i lanë në rrethinën e Prizrenit i morën me njerëzit e tyre Ali pashë Gucia dhe Korenica." J. Hadži-Vasiljević, Arb. liga. 59.

¹²⁷ Cf. Raportin e Jelinekut Andrashit, Prizren, 26 janar 1879. AIHT.

¹²⁸ K. Frashëri, LSHP I. 275.

merre në shqyrtim kërkesën për krijimin e vilajetit shqiptar. Prandaj, sipas shehut të Tetovës, lufta kundër Malit të Zi për mbrojtjen e trojeve shqiptare do t'i zvogëlonte gjasat për arritjen e këtij synimi madhor të Lidhjes.¹²⁹ Për këtë arsye Jelinek raportonte se “këtu për sheh Mustafanë thonë të gjithë se ai është një mbrojtës i vendosur i paqes...,”¹³⁰ ndërsa për mendimet “ekstremiste” të kadiut të Gjakovës folëm më lart.

Ahmet efendi Koronica u kthye nga Prizreni në Gjakovë, si duket për herë të fundit, më 30 dhjetor 1878, pikërisht në kohën e alarmimit të popullsisë së atjeshme se të gjithë muhamedanët e Sanxhakut të Jeni Pazarit po arratiseshin drejt Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit para marshimit të trupave austro-hungareze. Për qetësimin e malësorëve, të mbledhur në Gjakovë, pas këtyre lajmeve shqetësuese, u nevojiti një korrespondencë e dëndur me valiun dhe me mytesarifin e Jeni Pazarit derisa u demantuan këto thashetheme.¹³¹

Për veprimtarinë e mëtejshme të kadiut të Gjakovës nuk dimë aq shumë. Dimë se në fillim të janarit 1879 u ftua telegrafisht në Stamboll, por nuk dimë se kush e ftoi, përse e ftoi dhe përse nuk shkoi. Më vonë, me një telegram që arriti në Prizren më 6 janar 1879, sheh-ul-islami e emëroi Koronicën kadi në Manastir, për ku u nis më 16 janar 1879.¹³²

Megjithatë, kadiu i Gjakovës para se të nisej në detyrën e re i siguroi krerët e tjerë të Gjakovës se do të kthehej aty “sa herë që do të ishte e nevojshme prania e tij në Gjakovë, të luftohej kundër armiqve të vendit.”¹³³ Jelinek, si gjithmonë, edhe këtë herë e shprehte qëndrimin armiqësor ndaj Ahmet Koronicës, duke u orvatur ta njolloshte me çdo mënyrë veprimtarinë e kadiut të Gjakovës. Prandaj, me rastin e emërimit të tij ai shprehet: “Që Koronica iu bind pa kundërshtim urdhrit të sheh-ul –islamit është një dëshmi më bindëse se sa fort varen nga autoriteti dhe ndikimi i Stambollit ky anëtar i Ligës, si dhe të gjithë kolegët e tij.”¹³⁴

Ahmet efendiu e vazhdoi veprimtarinë e tij patriotike në kuadër të Lidhjes Shqiptare edhe gjatë qëndrimit të tij të shkurtër në Manastir, duke përkrahur programin politik të Komitetit të Stambollit, që u miratua në

¹²⁹ Op. cit.

¹³⁰ Jelineku, Andrashit, Prizren 15 tetor 1878. AIHT. Leka. 559.

¹³¹ Jelineku, Andrashit, Prizren, 26 janar 1879. AIHT.

¹³² Lidhur me këtë konsulli i Prizrenit raporton: “Një nga agjitorët më fanatikë, anëtar i Komitetit të këtushëm (të Prizrenit-MR), kadiu i Gjakovës Ahmet efendi Koronica, i cili në fillim u thirr telegrafisht në Stamboll, me një telegram të mëvonshëm të sheh-ul Islamit, që arriti këtu (në Prizren-MR) më 6 k. m. (të këtij muaji-janar 1879), u emrua kadi në Manastir, ku u nis më 16 të k. m. (“janar 1879-MR). Jelineku, Andrashit, Prizren, 26 janar 1879. AIHT.

¹³³ Ibid.

¹³⁴ Ibid.

mbledhjet ndërkrahinore të Dibrës më 14 tetor 1878 dhe të Janinës më 31 tetor 1878, program që pasqyrohet në rezolutat e shkruara, me këtë rast, nga dora e Abdyl Frashërit.¹³⁵ Këtë veprimtari e vë në dukje, në fillim të shkurtit 1879, vetë konsulli austro-hungarez në Manastir, Knapiç. Duke përshkruar veprimtarinë energjike të mutesarifit të Manastirit, Jusuf Zija beut, kundër “planeve të reja të Lidhjes Shqiptare,” që pasqyroheshin në rezolutat e përmendura dhe suksesin e tij për të detyruar disa krerë të shkëputeshin nga Lidhja, ai raportonte se “mes këtyre që ende s’i kanë dorëzuar mutesarifit dorëheqjet e tyre gjenden burra famëmëdhenj që kanë mundur të jenë në qendër të vëmendjes të pushtetit vendor dhe të qeverisë qendrore në Stamboll.” Këta ishin Seid beu nga Tirana dhe Iljaz pasha nga Dibra. Këtu hyn, sipas tij, edhe “Kadiu nga Gjakova, i cili posa është emëruar tani në Manastir, ku ushtron detyrën e vet.”¹³⁶

Duke bërë fjalë për veprimtarinë politike të këtyre krerëve të shquar të Lidhjes Shqiptare, kur ndalet te Ahmet efendi Koronica, shkruan: “Emërimi i kadiut të Gjakovës në këtë post në Manastir këtu shkaktoi një befasi të përgjithshme, sepse kadiu ka qenë i kalitur në çështjet e Lidhjes, mandej të gjithë e dinë se ai ka marrë pjesë në masakrimin e mareshalit Mehmet Ali pasha.” Sipas tij, posa arriti në Manastir, Koronica filloi të mbajë korrespondencë fshehtas me Iljaz pashë Dibrën dhe partizanë të tjerë të Lidhjes Shqiptare, “prandaj, vazhdon përfaqësuesi i Vjenës, ai po mbikëqyret nga pushteti vendor, por deri tani nga Stambolli s’ka ardhur asnjëfarë urdhri që do të përfshinte masa kujdesi dhe kontrollimi kundër këtij njeriu që edhe vetë prania e tij në këtë post aq të rëndësishëm jep shkas për interpretime dykuptimëshe.”¹³⁷ Nga ana tjetër, edhe konsulli austro-hungarez në Shkodër i raportonte ministrit të tij të Punëve të Jashtme, në fund të korrikut 1879, se kadiu i Gjakovës mbante nga Manastiri korrespondencë me Komitetin e Lidhjes Shqiptare.¹³⁸ Në dhjetëditëshin e parë të gushtit 1879, përkrahës të kadiut të Gjakovës morën poste të rëndësishme për të shmangur turbullirat e mëdha që kishin përfshirë Gjakovën dhe Prizrenin për shkak të lajmeve mbi depërtimin e ushtrisë austro-hungareze në Jeni Pazar dhe në Kosovë.¹³⁹ Jelinek raporton se “si masë kundër shkarkimit të Munibit (pashës-MR) Myftar pasha, dërgoi Emin efendiun, nipin e turbulluesit Koronica, si kryegjykatës në Prizren.” Por, diplomati austro-hungarez ishte i pakënaqur me këto masa, prandaj i lutet

¹³⁵ K. Frashëri, LSHP I. 277.

¹³⁶ Konsulli austro-hungarez në Manastir, Knapiç, Ahdrashit, Manastir, 6 shkurt 1879. Ark. i Kos. Leka. 225.

¹³⁷ Ibid.

¹³⁸ Lippih, Andrashit, Shkodër, 29 korrik 1879. AIHT.

¹³⁹ Telegram i Jelinekut, Zihit, Prizren, 11 gusht 1878. AIHT.

ambasadorit të tij në Stamboll “për largimin e Emunit prej këtu për sigurimin e qetësisë.”¹⁴⁰

Tash për tash, për mungesë informatash, nuk jemi në dijeni për veprimtarinë e mëtejshme të Ahmet efendi Koronicës deri në fillim të shtatorit 1879, kur vdekja mizore e ndau përgjithmonë këtë patriot të shquar dhe të nderuar nga të gjithë. Në lajmin e shkurtër për vdekjen e tij Ahmet efendi Koronica përmenëjt si “personalitet i rëndësishëm” i Lidhjes Shqiptare.¹⁴¹

Në Këshillin e Përgjithshëm që doli nga Kuvendi u zgjodh edhe A. Koronica, i cili me bashkëpunëtorë themeloi Degën e Lidhjes Shqiptare. Ai u dallua në vrasjen e Mehmet Ali pashës gjatë rrugës për në Gjakovë ku shkoi për dorëzimin e Plavës dhe të Gucisë Malit të Zi.

Vrasja e mareshalit osman, që pati jehonë të fuqishme si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë, shkaktoi mospajtime midis fraksioneve të Lidhjes Shqiptare. Ali pashë Gucia dhe A. Koronica, që konsideroheshin si ekstremistë nga diplomatët e huaj, formuan “Lidhjen e re” në Gjakovë, të cilës iu bashkuan edhe degë të tjera. Ajo kërkonte organizimin e një sulmi të armatosur kundër Malit të Zi. Me këtë nuk u pajtuan rrymat e tjera në Lidhje.

A. Koronica që mbeti në pakicë e vazhdoi edhe më tej veprimtarinë e tij deri në janar 1879, kur u emërua kadi në Manastir për ta mbajtur nën kontroll veprimtarinë e tij patriotike. Megjithatë, ai mbajti lidhje sekrete me krerët e Lidhjes deri kur vdiq.

Për ndihmesën e tij në luftë kundër pushtuesit osman, Ahmet efendi Koronica u bë burim frymëzimi për krijues të ndryshëm në fusha të artit dhe të letërsisë.

¹⁴⁰ Ibid.

¹⁴¹ Knapiç, Andrashit, Manastir, 5 shtator 1879. AIHT.

Prof. Dr. Masar RIZVANOLLI

ACTIVITIES OF AHMET EFENDI KORONICA DURING THE PERIOD OF
ALBANIAN LEAGUE PF PRIZREN

Summary

The Treaty of San Stephan caused an overall movement that covered all the layers of society and the entire Albanian-inhabited areas – a movement for summoning of an all-national assembly that would decide on an armed defense of the Albanian lands under threat by the neighboring Balkan countries. Therefore, the Istanbul Committee that launched an initiative for the formation of the Albanian League, elected a Commission with members Ymer Prizreni and Ahmet Koronica, who invited to Prizren, on 10th of June 1878, representatives from all of the Albanian territories.

The General Council deriving from the Assembly elected also A. Koronica, who founded the Branch of the Albanian League, in cooperation with others. He distinguished himself in the assassination of Mehmet Ali Pasha on his way to Gjakova, where he was headed to hand over Plava and Gucia to Montenegro.

The assassination of the Ottoman Marshal that had a resonance both inside and outside of Albania, caused disagreements among fractions of the Albanian league. Ali Pasha Gucia and A. Koronica, who were considered as extremists by foreign diplomats, formed “the new League” in Gjakova, with other branches joining. It demanded an organization of an armed attack against Montenegro. This was rejected by other currents within the League.

Remaining a minority, A. Koronica continued his activities till January 1879, when he was appointed *cadi* in Manastir so that his patriotic activities could be put under control. However, he kept secret ties with the heads of the League till the day he died.

